



Përtej Fjalës



**KAPRIÇOT,
FËMIJËT
PRINDËRIT**

Fara e zezë
Habbetus-Seuda

Suplement
*Per një Ramazan
si kurve me pare...*

Të kesh një mike ...

Intervistë me znj. Wedad Al Sewaidi
përgjegjëse pranë Ministrisë së Thirrjes
qeveria e Kuvajtit

**Kur gjuha flet
atë që është e
ndaluar**

Çfarë mund t'ju kujtojë, një zambak i bardhë përveç bardhësisë mbretërore të një fustani mbretëreshash?

Zambaku i bardhë, mendon për ju sikurse ju për vetet tuaja.

Duke ofruar në paketë, shërbimet e një fustani të bardhë për ditën tuaj të veçantë, atë të dasmës a fejesës suaj, çdo gjë vjen e stiluar dhe e ofruar ashtu siç duhet, e paparë vitrinave që shpesh na zhgënjnë.

Le të jetë një surprizë e bukur për bashkëshortin tënd, një fustan nusërie dhe çdo zgjedhje e jotja pranë butikut tonë

*Zambaku i
Bardhe*

-40%
për muajin
Ramazan



Marka të njohura si Levis, Caprioli, Benetton, Rubba Cuore, Malboro Classic, Rifle, Phard, Navigare

1. Kompleksi "Vizion Plus"
Rruga "Don Bosko", Tiranë
Cel.: 067 40 47 556

2. Pranë xhamisë së Tabakëve, 100 m në krah të saj. Cel.: 069 21 588 38 , 067 27 69 520
e-mail: zambakuibardhe@yahoo.com

Fustane nusërie (shitje/qera), kostume grash, pallto, pardesy, fustane, funde, triko, bluza, shamia, shalle

Përmbajtja

Editorial nga A. Muja	▶	4	Jam dhe unë...
	▶	6	Të kesh një mike...
nga STAFI	▶	9	Një vepër e madhe para një muaji të madh
Vetëm për zemrat nga K. Bardhi	▶	10	Ftesë për reflektim
Këndvështrim nga B. Haxhiu	▶	13	Përse stresi?
Seria e profetëve nga I. Tota	▶	15	Nuhu, profeti i parë i dërguar në Tokë
Trokas nga E. Rroshi	▶	18	Kur gjuha flet atë që është e ndaluar
Zëri im J. Derjaj / E. Fisheku	▶	20	Lindim të barabartë... marrim rrugëtime të ndryshme...
Dedikim nga E. Reçi	▶	22	Pa titull
nga O. Heta (Varrosi)	▶	24	Kapriçot, fëmijët dhe prindërit?
Mjekësi profetike nga A. Plumbi	▶	31	Fara e zezë
Imazh Erisa Kulla	▶	30	Të bukur e të shëndetshëm

Suplement ▶ 33 - 55

Ramazan 2010

Kryeredaktore: ALBANA MUJA (CIKU)

Redaktore gjuhësore: Prof.dr. Mimoza Gjokutaj

Recensues fetar: AHMED KALAJA

Art grafika: Ornela Bita

Organ i Shoqatës Kulturore: FEMRA INVESTIM I FAMILJES
TIRANË-ALBANIA





Jam

dhe unë...

Kur disa dënohen dhe jo vetëm diskriminohen (sikur kjo fjalë është gjetur me e butë) e kur disa të tjerë bëhen heronj të asaj çfarë janë po me zgjedhjen e tyre dhe jo kur ate ia mveshin natyrës, i takon të jetë akoma kohë përpjekjesh, që të kujtojnë demonstratat e përgjakshme të viteve të hershme mbi të drejtat e grave sidomos ato që lindën në Angli e që përfshinë më pas mbarë botën. Të paktën atyre viteve sikur ju shkonte një marrëzi e tillë, pasi mjaftohemi me faktin se qenë vite të porsa nisura në një demokraci vlerash e zgjedhjesh. Por tashmë, kur po rrumbullakosen jo vite e dekada, por edhe shekuj demokracie botërore, ende vazhdon shkelja me forcë e lirisë tënde, edhe pse është ngritur mbarë bota kundër diskriminimit të çdokujt e sidomos të grave dhe kjo si standart që duhet arritur medoemos.

Sërish jemi ne gratë më të diskriminuarat, e kësaj rradhe nuk bëhet fjalë për temën aq globalizuese, "diskriminim pozitiv" e as "mosbarazim gjinor", por diskriminim për atë çfarë je dhe beson, çfarë jep dhe kontribuon në shoqërinë ku bën pjesë. Sërish diskrimonohemi sepse pamja e jashtme është ndryshe ndaj të shumtëve. Sërish asnjë mundësi pune dhe zgjedhjeje, sërish stopohemi, kur aftësitë në degët ku kemi studiuar premtojnë për më shumë.

Në një nga kanalet televizive me famë botërore, kur u pyet një zonjë me peshë të madhe në pushtetin amerikan, ajo u shpreh: "Për sa kohë kemi diskriminim grash dhe vajzash, akoma kemi shumë rrugë për të bërë me "vetet tona".

E ndërsa një tjetër personazh i njohur (grua) kur u pyet me shumë ironi nga moderatori: se ç'mendonte kur shikon një grua me mbulesë në rrugë, a ju duket si gungë në mes një trotuari?- Ajo iu përgjigj: "Pak respekt për atë që " tregon respekt".

Pra ishte një përgjigje e duhur kundrejt një personi që s'para njej kufinj të shprehjes së lirë, por e rëndësishme ishte se këto fjalë dolën si mllaf ndaj kësaj makinerie të shoqërive që vazhdojnë të luftojnë diskriminimin, duke "diskriminuar". Këto shoqëri nuk gjejnë dot ilaçin e shërimit të shumë plagëve që ia mvëshin çoroditjes natyrore.

Kështu, vajzat apo gratë besimtare nisen rrugëve të gjata të jetës, ku shumëkujt nuk i pëlqen që ndan të njëtin vend e qiell me to. Atë ecën e silueta e tyre prej mbretëreshë kohësh romaneske ngjan aq e palëkundur. Ajo ecën nën këtë diell që rrëzëllon, që përskuq, që djeg, e djersitur, por jo e lodhur, e lënë mënjanë, e mërzhitur, e diskriminuar, e humbur.

Ajo ecën e qetë në këto ditë të nxehta vere, në këto ditë të nxehta agjërimit e kështu bota i duket sikur është vetëm e saj.

Të gjithë kanë vapë e vrapojnë pas ujit, freskisë mahnisë së "ftohtë" për të shuajtur etjen e këtyre ditëve që flakerojnë. Vajzat me mbulesë i shikon në të njëjtin hap të qeta, se do arrijnë aty ku duhet me vrapin e qetë, ku të çon vetëm një zemër që di të sakrifikojë e të DUROJË.

Organizohen tavolina e panele debatesh me njerëz të dijes e përparimit, por në fakt është e njëjta linjë ajo islamofobike. E themi vetëm me këtë term pasi nuk ka fobi vetëm ndaj shamisë, por kohëve të

fudnit islamofobia po përfshin fyerjet ndaj profetëve të Zotit, fyerje ndaj madhështisë së ezaneve që dëgjoen nëpër qytete e të tjera me rradhë.

Kjo ardhur ashtu siç edhe Zoti thotë në Kuran : ...Ata nuk do ndryshojnë bindjet e tyre po qe se ju nuk i ndiqni ata...." e kur e gjitha kjo fyerje e madhe vjen nga njerëz që me sa dukej në shkrimet e nënkuptuara tashmë njihte fare mirë botën e qenve, atë të ulëtën, të kafshëve ashtu siç edhe vetë jeta e tij mund të jetë, nuk ngelet gjë tjetër vetëm t'i thuhet : përgjigjen më të saktë nuk e merr as në një përballje me fetarë të zgjuar, as në një përballje më besimtarë të inatosur, por tek më I Durueshmi, që duron blasfemitë e të paditurve , mëkatarëve, vdekatarëve, për tu përballur një ditë të madhe me mëkatet e tyre me të cilat iu krenuan muslimanëve.

Si për të vazhduar këtë panoramë shtypjesh të drejtash, shikojmë me sytë tanë tek bëhen heronj e ju kushtohet vëmendje maksimale madje duke i dalluar madje nga të drejtat e të tjerëve, njerëzve me orientime të çuditshme seksuale, ata që vrasin, vetë frytet e jetës e martesës, familjes për të kaluar tek pedofilizmi, përçudnimi i vlerave duke investuar më shumë se ç'duhet për një emancipim të shoqërisë apo kopjim detajoz të shoqërive europiane.

Përse nuk është kjo fobi ndaj këtyre tendencave çnjerëzore, orientimesh denatyrore , kur këta tendenca janë përkundrejt çdo ligji hyjnor e njerëzor, por është ndaj një regulli shumë njerëzor fetar, siç është mbulesa apo diçka tjetër që mund të merret si tregues feje apo besimi, kur kjo e fundit nuk të ndryshon as në qenie, as karakter as në natyrë, por veçse e shndërron njeriun në " njeri që e mbarë shoqëria e vlerëson edhe pse shpeshherë nuk e duan kontributin e paqhtë që i japin mbarë problematikës së pazgjdhshme të shoqërisë sot.

Organizohen demonstrata në përkrahje të këtyre vajzave të përjashtuara, të tjerave të diskriminuara, por asgjë, përveçse një lajmi mediatik të dorës së tretë, ku në epiqendër vihet pirshja e qetësië apo demokracisë nga thirrjet e larta, apo shprehje të tilla si" kjo çështje nuk është se e prish panormën e vendit tonë të ashtuquajtur tashmë si eurpiano-perëndimor.

Një realitet i tillë që ngrihet si bajloz kundër të drejtave themelore njerëzore sikur i bën me dije pushtetarë dhe ata që kanë në dorë drafte dhe nene apo ligje ; ju që po luftoni diskriminimin si standart për tu bërë pjesë e hapësirave europiane, ju në fakt nuk po e zhdokni atë, por po i fryni një zjarri, i cili djeg edhe ato pak vepra të mira që keni bërë rrugës së gjatë të europianizimit.



Të kesh një mike ...

INTERVISTË ME ZNJ. WEDAD AL SEWAIDI PËRGJEGJËSE PRANË MINISTRISË SË THIRRJES QEVERIA E KUAJTIT

Një zonjë që kish pak ditë që kishte mbërritur në Shqipëri, një zonjë nga ato që kur e shikon të kujton zonjat që përshkruhen librave letrarë e historikë, ku del në pah gruaja me pozitën e saj, me kulturën, delikatesën dhe gjithçfarë çfarë flet për të, flet me një siguri të rrallë prej fisnikeje.

Ka pak ditë dhe ne jemi takuar në vazhdën e takimeve që në fakt gazetarët ruajnë të sigurojnë kur dikush vjen nga jashtë vendit, për të takuar njerëz dhe fate të po këtij vendi.

Shumëkush u mahnit nga publiciteti i bërë Shqipërisë për të qenë vizitor i shkujdesur, për të shijuar bukuritë apo plagët e vendit tonë dhe për të ikur i qetë në vendin e tij me ca kujtime më shumë, por me zonjën në fjalë nuk është thjesht kështu.

Kur u takova dhe fola me të, ish një zonjë shumë e përgatitur, e lexuar, e shëtitur dhe me plot urtësi. Ajo më mësoi se edhe në fjalë, jo vetëm në dukje, duhej dalluar gruaja e ditëve të sotme.

Për nga vetë pozicioni që mban në Kuvajt si edhe duke qenë një pozicion i mirëgjetur për një grua si ajo që ka shumë çfarë jep, e pashë të arsyeshme të përfitoj nga koha e saj disa minuta freskie.

Duke qenë grua, kjo mbërthen në vetvete një kërshtëri direkte, për ta pyetur se prej sa vitesh e mban këtë post, si i shikon marrëdhëniet me kolegët, me masën e gjerë, si qëndron thirrja në islam në vendin e saj, cilat janë ecuritë, problemet, situata e të rinjve, etj. etj., pyetje pa fund.

Por tek ajo flet, mëson sërish se fjalët duhet të jenë të pakta, sepse kur thuhet plot hir ata janë magjike dhe mjaftojnë si të ishin grumbuj librash.

Kur e pyes për fillimin e saj në islam, ajo e pret si me çudi:

Unë në islam kam qenë dhe lindur, në gjyshër e stërgjyshër të mi. Ne jemi vend mysliman e ku shumë pak mund të jenë besimtarë të ndonjë feje tjetër dhe fillon të ravijëzojë një copëz harte të Kuvajtit e më tregon mbi shtrijen e tij gjeografike, kur më shpejgon se kohë më parë, vite pas vitesh qëkur profeti i Zotit kishte shtrirë thirrjen për në islam, besimtarët e feve të tjera, si jehudë apo të krishterët kishin kapërcyer kufinj të Kuvajtit dhe popullsia kuvajtijane që thjesht e bukur. Një vend i begatë besimtarësh monoteistë - myslimanë.

E pyes se si qëndron situata atje, a janë duke kërkuar të rinjtë kuvajtjanë civilizimin perëndimor apo janë të lidhur ngushtë me besimin dhe traditat e tyre? Kush është problemi më i madh i tyre? E ardhmja e tyre do të jetë e ndryshme, e çuditshme, apo më e sigurtë?

Ajo shprehet se situata mbarëbotërore është e tillë që të ofron çudira e të papritura, edhe pse nuk është dakord me trumbetimin që po i bëjnë fjalës globalizim në mbarë vendet.

Jo,- shprehet ajo, çdo vend duhet të ruajë drejtimin e tij, besimin e të parit e më pas traditën.

Probleme nuk ka si në Shqipëri, si p.sh.: shumë të varfër e të pasur më pak, sidomos të rinjtë janë akoma më ndryshe, por sërish ka ngërçe sa i takon edukimit të tyre. Ata harxhojnë shumë kohë në internet, në chat, facebook, etj., por jo më shumë.

Tani hidhemi tek „gratë“ sa të ndërgjegjshme janë ato për rolin që kanë mbi supe, sa ia kanë arritur, dhe sa duhet. A kanë arritur të shkëmbejnë eksperiencë, aq sa ju mjaftojnë për të pasur një botëkuptim të kompletuar?

- gratë, si çdo grua, në pozicionin e asaj, pra siç edhe është një grua që nuk i numërohen fakultetet që ka kryer e ku momentalisht pret të diplomohet në fakultetin e saj të radhës, atë të profilit të dauas, ajo shprehet se gratë kanë bërë, janë përpjekur por jo aq sa duhet.

Ajo është „nëna“ dhe nëna asnjëherë nuk kënaqet me frytet e fëmijëve të saj, ajo duhet të jetë kërkuese e më kërkuese ndaj vetes e ndaj fëmijëve, ndaj edhe një grua duhet të jetë kërkuese ndaj vetes dhe ndaj detyrave të saj, ndaj edhe i krahasova detyrat me fëmijët, sepse ashtu duhet ti shohim, si amanet, si domosdoshmëri për t'i kryer mirë e saktë, e në mënyrë të vazhdueshme, për të kujtuar veten e rikujtuar të tjerët, jemi gra me detyra e të drejta. Detyra jonë dihet, por krahas kësaj kemi të drejtat që nuk duhet absolutisht t'i humbasim, por t'i ruajmë duke bërë kujdes, e dua tek Ai që i pranon Lutjet. Sërish ka shumë për të bërë. Unë shikoj kudo që shkoj, por ja edhe këto ditë në Shqipëri, njerëz që respektojnë njëri-tjetrin, më respektojnë edhe mua, janë shumë të dashur, miqësorë, por kur i pyet për diçka që unë e quaj të thjeshtë për ta ditur, ata përgjigjen duke ngritur shpatullat: -Nuk e di, e kush ishte pyetja?

-Çfarë besoni, i kujt besimi jeni? Kishte shumë prej tyre që rrudhnin shpatullat. Pse

kjo, ju bëtë 20 vite demokraci, liri, shprehje të lira, mundësi. Do duhej akoma punë e përpjekje. Unë kuptoj se ka vështirësi, por gjithnjë duhet të kemi gojën e patharë nga përmendja e Zotit, nga ndihma që duhet t'ia këkojmë Atij për udhëzim, për të rinjtë, të vegjëlit, kudo me urtësi e durim, vetëm Ai (Zoti) nuk mërzitet kur i kërkon diçka. Ai është Drejtuesi i çështjeve, Furnizuesi! E them këtë sepse është parë e rrugës në fillim ndihma e këtyre njerëzve monetarisht, me nënshtesën se do pranojnë e do afrohen me islamin, por nuk ka ndodhur tamam ashtu, ndaj sot duhen shumë ftesa, thirrje e durim në të.

I drejtohem sërish e i them se ju jeni grua dhe në një pozicion që flet shumë për mundësi dauje, cilat janë aktivitetet tuaja atje.

Përveç kuptimit klasik të pozicionit që kam, unë jam afër me kolegët, vartësit apo të tjerët.

Ne jemi njerëzit, Allahu është i të gjithëve. Kështu aktivitetet janë nga më të ndryshmet, në ndihmë të fesë islame, të kulturës e etikës qytetare. Kur kam udhëtuar për këtu, ju kam lënë në porosi e madje si në kontroll të vetes së tyre, libra e broshura për të lexuar e për t'u përgatitur më pas për testim mbi ato që ju lashë. Me mbërritjen time atje, do fillojmë riashtazi me të tjera aktivitete.

Në kontekstin e revistës "Përtej fjalës", dhe për këtë arsye po i merrja intervistë, pasi edhe kjo ngrihet mbi një staf femrash, mbi rolin e medias, fuqinë e shtypit etj., sa ndikon revista, gazeta, libri, fletushka, në kohën kur leximi po njuh një goditje të madhe?

Ajo është e mendimit se daua nuk arrihet aq mirë me revista e libra, por me ftesa gojore e mundësi dauje sikurse profeti në mesin e sahabeve.

Ajo thotë: Jo, rëndësia e librit njihet dhe madje që në kohërat e hershme, pra që në kohën e Uthmanit kur u mblodh libri, pra Kur'ani në fleta, do të thotë se lindi nevoja për ta memorizuar, por edhe për ta pasur të shkruar, pasi ata që e njihnin përmendësh, që e memorizuan po vdisnin, po iknin dhe se bashku me to do ikte edhe dija, e shkencat, besimi e çdo gjë veç historive të bukura që mbahen mend lehtë. Libri, revista apo gazeta kanë rëndësinë e tyre, jo çdokush mëson me të thënë, por duhet ta lexojë diku, t'i shikojë argumentet, t'i përqasë argumentet me njëra-tjetrën, t'i mbushet seriozisht mendja e arsyeja.

Unë këtu çuditem kur dëgjoj për shumë shtyp dhe liri të tij, por për fare pak revista kulturore fetare.

Atje është e kundërta, ju e kuptoni pse. Atje shpërndahen revista, fletushka falas, për çdo njeri, për çdo kalimtar, në çdo shtëpi, dyqan apo ndërmarrje, bankë apo institucion.

Një mundësi e tillë shpërndarjeje ose kujtese tek çdo njeri vlen shumë, ne jemi vetëm për t'ju kujtuar, këshilluar veten e të tjerët, ja shikoni, ne jemi këtu, por Zoti është lart, dhe Ai ju do juve, nëse ju do ishit "me Të" duke lënë të kuptohet nëse do ndiqni rrugën e drejtë siç e ka skicuar Ai në Kur'an dhe profeti i fundit në thëniet e tij. Shtypi është një mundësi e mirë për dauan, sërish do gjenden njerëz që do lexojnë, ose të paktën bëni ju dua që të lexojnë, kërkoni më shumë, përveç materialeve që shfaqni aty, bëni që ata të shkojnë në zemër e në sy të etur për lexim, e kureshtarë në maksimum për të mësuar, kjo po, kjo na duhet !

Po troket ramazani në një muaj të nxehtë për Shqipërinë dhe nuk harroj t'i bëj një pyetje se çfarë do ju thoshte nënave shqiptare ajo si nënë e tre djemve.

Me thjeshtësinë e saj shprehet e qeshur.

- Tek ju bën vapë?! Jo. Ndoshta ne jemi mësuar, por kur tek ne vapa kapërcen 55^oc e tek juve valëzon drejt 40^o nuk është vapë, madje më duket freskët tek ju. Nuk ka vështirësi, Allahu për çdo gjë sjell lehtësim, por ju mos harroni lidhjen me Të.

Nënave, ato janë qendra e shtëpisë, e familjes, baza, prehri i saj gjithnjë me plot fëmijë e përgjegjësi.

Roli i gruas është gjigand. Asaj i duhet të kujtojë gjithnjë lodhjet e sakrificave e grave të larta, atyre të dalluarave për besim e durim. Duhet të dyrojë, të ecë e lartë e me siguri se dëshira e saj do plotësohet nëse është e palëkundur në atë çfarë do dhe me mbështetje. Kudo e në çdo kohë të jetë në dua për të vegjëlit e saj. Madje edhe në shtëpi, ku ajo rri më së shumti, të vërë në mur apo dyer, dua të profetit për çdo detaj ndihme dhe lehtësimi siç janë dua ja në hyrje të shtëpisë, e daljes prej saj, e fillimit të ushqimit, e mbarimit të tij, duate e gjumit, para tualetit, fleta të ngjitura mureve, etj. Janë të thjeshta, por na kujtojnë gjëra të mëdha, gjëra të një rëndësie të madhe, edhe pse janë fare të vogla. Kudo të jemi të rrethuar nga to. Kështu jemi më vigjilentë, bëhemi më të programizuar, e rrjedhimisht më falenderues, më të kujdesshëm.

Nënat duhet të kenë parasysh edhe agjërimin e të vegjëlve. Dihet, ata duan lehtësim, ata duan butësi, - "Bëni durim, se Allahu ju dhuron mirësi më shumë", - "Ja si agjëron mami, ja edhe babi, edhe vëllai i madh apo motra". Ju e kaloni kohën me gjëra të lehta, e lojëra apo preokupime që jua lehtësojnë agjërimin. Gjithnjë duke e bërë islamin e lehtë sepse po, ai është vërtetë i lehtë, dhe njerëzit e vështirësojnë atë.

Ju faleminderit dhe suksese në punën tuaj!

Intervistoi dhe përshtati nga anglishtja: Albana Muja

NJË VEPËR E MADHE, PARA NJË MUAJI TË MADH

KISHIN THËNË SE PO BËHEJ DIÇKA E BUKUR, ME SHUMË SFORCO, ME LODHJE, POR ME SHUMË DËSHIRË E SHPRESË TË ISHIN TË DOBISHËM PËR NJERËZIT DHE SE NJË DITË NË DYNJA E AHIRET, VETËM ALLAHU DO SHPËRBLENTE PËR TË.

Është fjala për "XHAMINË E BARDHË"

E ndërtuar dhe e përfunduar para pak ditësh, kjo xhami prej katër katesh, e bardhë brenda dhe jashtë saj, kishte tërhequr mjaft shikimin e kalimtarëve dhe të udhëtarëve që vinin nga Durrësi për në Tiranë dhe anasjelltas. Një veçanti që nuk ishte parë më parë, ngjyra si prej mermeri dhe dy minaret e larta, investimi përrallor i bërë në të, e bëjnë akoma më madhështore.

Kishim parë e dëgjuar që shoqata dhe organizata të tjera, në vazhden e përhapjes së islamit, kishin ndërtuar xhami dhe institucione të tjera ku përfiton një publik i gjërë, por ky projekt i kaloi çdo hamendësim se edhe një familje vogël mund të dhurojë vërtet diçka shumë të madhe.

Kështu, një familje fare e vogël me 3 pjesëtarë besimtarë, por me një vizion të lartë e zemër të madhe, dhuruan për të gjithë popullatën e asaj zone, por edhe për shumë të tjerë, një shtëpi prej shtëpive të Zotit. E tëra për ta, për të pasur

edhe ata vend të qetë falje e meditimi. Një punë e palodhur, me sforco e me mundimin që të dalë diçka vërtet e bukur, vjen si punë e mirë para një muaji të begatë, e jo pa qëllim.

Me këtë dhuratë administratorët e saj, çifti Qoli duan të jenë afër këtij komuniteti që medoemos e donte një ambient të tillë që ju mungon madje edhe qyteteve më të populluara e më të mëdha. Kjo vepër para Ramazanit, Ramazan 2010!


Të shumtë do jenë ata që do falen që në këtë ramazan dhe duatë e tyre do kapërcejnë minaret e larta për t'u ngjitur tek Përgjigjësi i lutjeve. E ndër këta lutje, lutje pa fund, do jetë edhe duaja e sinqertë për këtë familje, që të gjejë shpërblimin më të madh në dynja e ahiret.

Çdo punë e bërë për hir të Zotit, e ka shpërblimin, shpërblim të shumëfishuar. Kjo do ishte një mirëpritje e Ramazanit, një pritje madhështore që na përkujton edhe ne të tjerëve, ta presim atë me punë e vepra të mira e ta përcjellim po ashtu.

E mirëshikuar deri në çdo detaj, në çdo anë e kënd, ajo është nga ndërtesat për t'u marrë shembull sa i përket rëndësisë së treguar për të falur diçka që vërtet ka vlerë e mbart mirësi.

Më së shumti duket sikur merr vlerë, kur kjo punë erdhi si spunto dhe si ndihmë e herë pas hershme që një grua di t'i dhurojë bashkëshortit të vet Petrit Alush Qoli, e kjo është një bashkëshorte e ditëve të sotme, të zisë ekonomike, por që urdhëron për të mirë dhe ndihmon në të, kontribuon për diçka më të mirë e në kontribute që fare mirë e përcjellin tek vajza e tyre, Ejona.

I falenderojmë pa masë për kontributin e tyre, suksese në projektet e tyre.



VETËM PËR
ZEMRAT

Vdekja, edhe pse në përgjithësi ka shenja dhe gjurmë të qarta, gjithsesi ajo vazhdon të mbetet mister që i huton mendjet e të urtëve, ngase ka lidhje me vetë shpirtin, i cili gjithashtu është enigmë. Zoti në Kur'anin Famëlartë thote: "Të pyesin ty (Muhamed) për shpirtin. Thuaj: Shpirti është çështje e Zotit tim. E juve nuk u është dhënë veçse pak dituri". (El-Isra 85).

Sa e veshtirë është për zemrat ndarja nga të dashurit e të shtrenjtët! Mirëpo kush i beson Zotit kënaqet me caktimin e Tij, e njeh këtë ligj të Zotit për krijesat e Tij dhe shpreh bindje ndaj Tij.

Vërtet, vdekja është fatkeqësi. Kështu e cilëson Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an. Mirëpo harrimi i kësaj të vërtete të padiskutueshme është fatkeqësi më e madhe. Shume njerëz enden të dehur në kotësinë dhe verbërinë e tyre, edhe pse çdo ditë shohin argumenta të fuqishme e prova të pakontestueshme dhe dita-ditës u shtohen sprovat e belatë. "Njerëzve po u afrohet dita për të dhënë llogari, mirëpo ata vazhdojnë të jenë të shkujdesur e të shmangur(nga e vërteta)". (El-Enbija 1)

Ftesë për reflektim

(Meditim rreth misterit të quajtur "vdekje").

"(Ai) i Cili ka krijuar jetën dhe vdekjen për t`ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë. Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i Madh". (El-Mulk 2).

"Vizitoni varrezat, sepse ato j`u kujtojnë Ahiretin ... ". (Transmeton Tirmidhiu).



Nga: Kastriot Bardhi

Me të drejtë një dijetar shprehet: “Nuk kam parë ndonjë gjë të sigurtë, që tek njerëzit përngjan me të dyshimtën–sesa vdekja”. Kjo sepse, në çdo ditë percjellim njerëzit tanë për tek varrezat, u japim lamtumirën e fundit dhe pikëllohem për ndarjen me ta. Mirëpo fatkeqësisht, kur kthehem në shtëpitë tona, në vend që të reflektojmë e të marrim mësim, ne zhytemi në vorbullën e jetës, e harrojmë vdekjen dhe i kthehem përsëri gjynaheve.

Padyshim, vdekja është e sigurtë, e pashmangshme. Askush nuk mund t'i shpëtojë asaj. Zoti Lavdiplotë në Kur'an thotë: “Çdo njeri do ta shijojë vdekjen. Shperblimet do t'ju plotësohen vetëm në Ditën e Fundit. Kushdo që shpëton nga Zjarri i Xhehenemit dhe hyn në Xhenet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet). Ndërsa jeta e kësaj bote është kënaqësi mashtruese”. (Al-Imran 185). Ky është realiteti i vdekjes dhe i asaj që vjen pas saj. Vdekjen do ta shijojë secili prej nesh, kushdo qofte ai: i varfër apo i pasur, i sëmurë apo i shëndetshëm, i vogël apo i madh, me pozitë të ulët apo të lartë në shoqëri. Ajo nuk pyet për asgjë.

Prandaj askush të mos mashtrohet nga rinia, bukuria, fuqia, shëndeti, pozita e pasuria.

Vdekja është mysafir i paftuar. Ajo nuk të merr leje kur vjen, sikurse nuk të është marrë pëlqimi kur Zoti të sollti në këtë botë, pasi që më parë nuk ekzistojë fare.

Vdekja nuk njeh moshë. Ajo mund ta marrë te riun para të moshuarit, të shëndetshmin para të sëmurit. Ti sheh një djalosh të ri, të shëndetshëm, impulsiv dhe energjik. Mirepo mjafton një moment i shkurter që ai të shndërrohet në kufomë, trup i ngrirë, pa jetë. Pak më parë ai kënaqej me shëndetin e bollëkun, luante e dëfrente, jepte urdhëra e ndalonte gjithë kompetence. Nderkohe i erdhi vdekja. Ajo iu versul si luani gjahut te vet, e per pasojë ia dobesoi trupin, ia uli zërin, ia shterroi fuqitë dhe ia palosi fletët e veprave. Pastaj e mori me vete. E largoi nga kjo bote. Atij i iku koha e punës. Tashmë për të filloi koha e llogarisë dhe shpërblimit. Ndoshta ky i ndjere mund të ketë qenë shkencëtar i famshëm, akademik i shquar apo njeri me grada të larta shkencore, ose gojetar e orator i mprehte apo mjek i kualifikuar që kuronte të njëjtën semundje nga e cila

Njeriut i mjaftojnë si këshillë dy gjera: Kur`ani dhe vdekja. Njerëzit që nuk marrin mësim nga Kur`ani, nuk u zbutet zemra prej tij dhe nuk i tremb vdekja, vërtet këta janë me zemërgurtët. Jane ata që kanë vdekur për së gjalli. Sikur malet t'u thërrmoheshin para syve, zemrat e tyre nuk do të zbuteshin.

VETËM PËR ZEMRAT

vdiq. Asgjë nuk i ben dobi ne Botën Tjetër, përveç besimit dhe veprave të mira, që janë fruta të këtij besimi.

Sa afër është vdekja! Çdo dite ajo afrohet drejt nesh dhe ne afrohemi drejt saj. Ndërmjet nesh dhe asaj nuk ka mbetur vetëm se plotësimi i afatit, i kohës se ndarjes nga kjo botë. Atëherë kur te na vije kjo minute ne do të rreshtohemi në radhet e te vdekurve.

Realisht jeta është si nje lule qe çel e lulëzon, pastaj vyshket e thahet; ose si nje llambe qe ndriçon, pastaj shuhet; ose si një urë zjarri që bën dritë, pastaj shkrumbohet, bëhet hi.

Ne jemi te perkohshem në këtë botë, si kurbetçinj apo udhëtarë. Çdo udhëtim e ka një fund. Fundi i udhëtimit tonë është vdekja. Treni i jetes sone po i afrohet stacionit. Disa njerez të mirë degjuan disa të tjerë që qanin një të vdekur. Ata thane: "Çudi me këta udhëtarë që qajnë për një udhëtar, i cili ka mbërritur në shtëpinë e vet".

Një njeri i mençur (Aun.b.Abdilahi) shpeshherë thoshte:"Sa njerëz e nisin ditën e re, por nuk e plotesojnë atë! Sa të tjerë e presin të nesërmen, por nuk e arrijnë atë! Sikur ta shihnit vdekjen dhe levizjet e saj, ju do t'i urrenit ëndërrimet dhe mashtrimet që vijnë prej tyre".

Ku jane ata që iu përkushtuan tërësisht kësaj bote?! Ku janë ata qe grumbulluan shume pasuri me mund e sakrifica, por nuk e shijuan kurrë atë?! Ku janë ata që ndërtuan vila magjepse në të cilat nuk banuan kurrë?! Mirëpo ne e harrojmë vdekjen dhe notojme ne detin e kësaj bote sikur të na jetë dhënë premtimi se nuk do të vdesim kurrë. Sikur vdekja t ishte hak për të tjerët, por jo per ne! Sado e këndshme të jetë kjo jetë, do te vijë momenti kur do të zbehet dhe më në fund do te humbasë, sikur të mos kishte ekzistuar fare. Lum ai qe përgatitet për vdekjen dhe e pret atë para se ta zërë në befasi! Duke përkujtuar vdekjen ne nuk kemi për qëllim që të dekurajojmë njerezit, qe ata te lene shkaqet për të berë një jete sa më të denje, as nuk duam t'i stresojmë që të braktisin punen e prodhimin.

Perkundrazi, duke ua kujtuar vdekjen, duam qe ata të bëhen njerez me të mire e me dinjitoze, si dhe qe t'a rritin kualitetin e punes dhe prodhimit. Ne dëshirojme të ndikojmë pozitivisht për të larguar prej tyre frikën, ankthin e streset qe vijnë nga fatkeqësitë e problemet e jetës dhe që ata të mos mashtrohen nga bukuria magjepsës e kësaj bote.

Ne e përkujtojmë vdekjen që të përgatitemi mirë për të dhe për atë çfare vjen pas saj. Ne duhet të përgatitemi duke bërë të gjitha ato vepra të mira që i dëshiron Zoti siç janë: falja e namazit, agjërimi, respektimi i prindërve, ruajtja e lidhjeve të gjakut, sjellja e mirë me njerezit, ndihma e solidariteti me të përvuajturit, urdhërimi për mirë, ndalimi nga e keqja etj. Abdurrahman.b.Mehdi ka thënë për Hamad.b.Selemen:"Sikur atij t'i thuhej se është e sigurtë që nesër do të vdesësh, ai nuk do te shtonte asgje nga ajo çka bënte çdo dite". Kjo , sepse ai gjithë kohën e vet e kishte mbushur me vepra të mira dhe adhurime.

Të përgatitesh për vdekjen do të thotë të heqësh dorë nga të gjitha format e politeizmit, sepse ai është gjynahu më i madh, të cilin Zoti nuk e fal. Gjithashtu të heqësh dorë nga të gjitha gjynahet e poshtersitë e tjera dhe t'i kthesh hakun çdokujt qe i ke bërë padrejtësi, ta pastrosh zemrën nga zilia, urrejtja e armiqësia.

Çdo njeri që është i vetëdijshëm se një ditë do të vdes, le të përgatitet për atë ditë, le ta përkujtojë vazhdimisht vdekjen dhe të meditojë rreth saj. Ti, o njeri, do të vdesësh, edhe nese jeton 100 vjet.

Mos mendo se vdekja, e cila merr përditë jetë njerëzish, do të të lërë ty të gjalle! Zoti i Lartmadhëruar thotë:"Ajo qe u është premtuar patjetër do të vijë. Ju nuk mund ta pengoni". Prandaj konsideroje veten prej të vdekurve, prej banorëve të varrezave, sepse, çdo gjë që është duke ardhur është afër...

Zoti na bëftë prej atyre që e përkujtojnë vdekjen dhe përgatiten për të.



KËNDVËSHTRIM



PËRSE



Ditët që njeriu kalon, janë si një litar i shtrirë të cilin ai nuk e din, se kur mund të këputet. Skajet e këtij litari janë e shkuara dhe e ardhmja e tij. Ndodh që kur hedh vështrimin nga e kaluara brengoset e dëshpërohet për të e kështu përfundon në dembelizëm, por mund të vështrojë dhe në të ardhmen duke zgjatur qafën ta zbulojë para se ajo t'i shpaloset. E në realitet njeriu nuk ka tjetër veç momentit që ai jeton; sepse të djeshmes së shkuar nuk ia shijon dot mirësinë dhe nuk e ndien peripecinë e saj, po ashtu e ardhmja për të është një e fshehtë e cila mban rrezik, ndaj dhe njeriut nuk i ka ngelur gjë tjetër veç kohës në të cilën ai jeton. Kështu ai nuk mund ta kthejë dot të djeshmen dhe as nuk mund ta sjellë dot të nesërmen.

Përderisa njeriu është një qenie që mbarat shpirt, patjetër që do të jetojë atë që i është caktuar tek e cila nuk mungojnë fatkeqësitë ku rrallë herë mund të evitohen prej tij habitë. Po ashtu dhe fladi gjatë jetës së njeriut nuk mund ta gjallërojë vazhdimisht dhe pa asnjë kufi atë që lëngon; sepse peripecitë janë të shumta dhe bezdisjet të vazhdueshme, ndërsa porta e qetësisë herë hapet e herë mbyllet. Nga këto mendime dhe shqetësime lind dhe zhvillohet brenga e cili ka shqetësuar zemrat dhe ka tronditur burra dhe gra e ajo është stresi.

Sigurisht që stresi është ndjenja e cila përshkon njeriun, e cila e hedh atë në mërzi, paqëndrueshmëri dhe pesimizëm, duke rivalizuar kështu rehatinë, qetësinë dhe optimizmin. Nëse njeriu arrin këtu, ai nuk ndien qetësinë e gjumit, nuk ndien shijen e ushqimit e as nuk mund të gëlltis dot më ujë.

Po, ai është stresi i cili e bën njeriun të ndiej se dita nuk do ta arrijë kurrë natën dhe se nata kurrë nuk do të zëvendësohet me ditë; ai i bën lëvizjet e akrepave, si orë të gjata. Po, për Zotin sa e gjatë që është nata për atë që nuk e zë gjumi!

Stresi e çorienton kujtesën dhe e shpërqendron mendimin, ia ngushton njeriut atë e cila është e gjerë edhe nëse jeton në kështjellë luksoze apo në gradaçelë gjigande. Gjoksi i tij ngushtohet sikurse i atij i cili ngjitet në qiell e vazhdon kështu derisa ta hedhë në disfatë apo ta bëjë prej të shkatërruarve.

Stresi

ÇFARË THOTË ISLAMI PËR TË?

E kush prej ne ka mundësi të jetojë jetën e tij pa ndonjë stres, apo që të ketë shpëtuar nga pluhuri i tij! Porse gabon shumë rëndë ai i cili e bën stresin si monopol të nevojtarëve dhe atyre që vuajnë e s'përmbushin dot nevojat e tyre, sepse ne shohim njerëz me pushtet që janë të stresuar, pasanikë të çorientuar, sikurse shohim dhe fukarenj të qetë e të rehatuar.

Në realitet shumë njerëz ankohen nga furtunat nëpër të cilat kalojnë, apo errësirat të cilat i befasojnë herë pas here, edhe pse ne e dimë se lodhja dhe dhimbjet janë si ajo toka pjellore nëpër të cilën mbinë bimët e forcës dhe gjallërisë dhe se produkti i të mëdhenjve vjen pikërisht në mesin e përgut të mundimeve dhe përpjekjes.

Nëse njeriu do t'i kthehej vetvetes qoftë dhe për një çast, ai sigurisht që do t'i akuzonte ndjenjat e tij të trazuara përballë atyre që e godasin. E kush e din, se ndoshta diçka që duket e dëmshme të jetë e dobishme? Madje kush mund ta dijë se shërimi i trupave ndonjëherë vjen dhe nga sëmundjet? Madje ndodh që dhe sprova brenda saj të ketë të rezervuar dhe dhuratën? Sa gjurmë janë lënë pas nga njerëz të cilët janë munduar?

Ndodhitë dhe mjerimet, edhe pse shfaqen sa në lindje e në perëndim, ato nuk mund të prekin veçse atë të cilit i është shkruar ndonjë gjë e tillë. Atëherë përse duhet të stresohemi? A nuk e dimë ne se, fundi i çështjeve është diçka e rezervuar tek e fshehta dhe se ndodh që ajo që duam të jetë ke ajo që urrejmë dhe të mirën ta gjejmë tek ajo e cila mendojmë se është e keqe. "Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një

gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Zoti di, kurse ju nuk dini". El Bekare: 216.

Ibrahim bin Edhem kaloi njëherë pranë një njeriu të stresuar dhe i tha: Do të bëj tre pyetje ndaj mu përgjigj: "A ndodh në këtë gjithësi diçka pa dëshirën e Zotit? A mund ta pakësoj furnizimin tënd diçka që Zoti nuk e ka caktuar? A mund të pakësohet jeta jote qoftë dhe një çast të vetëm, nëse Zoti nuk e ka dëshiruar? Ai iu përgjigj: Jo. Pas kësaj Ibrahim i tha: "Atëherë përse i gjithë ky stres?"

Ali ibën Ebi Talib ka thënë:

Vallë cilës ditë t'i iki ?

Ditës që është caktuar ?

Apo asaj që ende jo?

Ditës që s'më është caktuar,

S'kam pse t'i friksohem.

Ndërsaditësqëmëështëcaktuar

Dot nuk mund t'i shpëtoj.

Atëherë përse i gjithë ky stres?

Nuk ka dyshim, se nga veçantitë e fesë Islame është orientimi që ajo bën për çdo të mirë dhe qortimi që ajo bën për çdo të keqe. Dhe ajo për të cilën ka orientuar feja jonë e pastër është dhe aspekti, se stresi i pa kontrolluar është i rrezikshëm për shoqërinë dhe prodhimtarinë e tij, sepse mirësia e vërtetë është që çdo shoqëri muslimane ta presë jetën me gëzim dhe shpresë, në mënyrë që të përfitojë nga koha e saj dhe të çlirohet nga prangat e brengave dhe pesimizmit.

Njeriu në asnjë moment nuk duhet ta lejë veten e tij peng të stresit i cili do t'ia shkatërrojë veprat dhe do ta hedhë në përtaci e paaftësi, ndaj dhe Profeti Muhamed , i kërkonte mbrojtje Zotit nga stresi dhe mërzia. Ai gjithashtu ka thënë: "Kush thotë në mëngjes dhe mbrëmje: "Më mjafton mua Zoti; s'ka të adhuroar tjetër përveç Tij. Tek Ai jam mbështetur dhe Ai është Zoti i

Arshit të Madh." shtatë herë, do t'i mjaftojë për atë që e streson dhe e brengos." Ebu Daudi

Ndaj dhe çdokënd nga ne që e mbulojnë streset, duhet që patjetër ta përkujtojë e përmendë me falëndërim Zotin e tij në mënyrë që të dalë nga gypi i shishes për në hapësirën e gjerë. Largimi i stresit është i varur nga përkujtimi i shumtë i Zotit dhe vazhdueshmëria e tij. Profeti ka thënë: "Çdo kush që i përmbahet kërkimit të faljes, Zoti do t'i japë për çdo vështirësi zgjidhje, për çdo stres e brengë rrugëdalje dhe do ta furnizojë nga nuk e pret". Ebu Daudi dhe Nesaiu

Nuk do të na sjellë asnjëherë dobi drejtimi ynë për nga filani apo dikush tjetër, nëse më parë nuk kemi trokitur në derën e Mëshiruesit të pakufishëm, i cili i shikon dhe i din atë që mbajnë gjokset. Ai që e ka humbur gjetjen e qetësisë nga Zoti, vështirë të mund ta gjejë diku tjetër?!

Një herë Profeti hyri në xhami dhe gjeti në të një burrë prej ensarëve i cili quhej Ebu Umame. Ai i tha: "O Ebu Umame, si është puna jote që po të shoh në xhami në një kohë në të cilën nuk ka falje?" Stresi dhe borxhet që më kanë zënë o i dërguar i Zotit. Profeti i tha: "A të mësoj diçka me të cilën do të largohen streset e tua e do të shlyet borxhi yt". Sigurisht o i Dërguar i Zotit i tha sahabi. Thuaj mëngjes e mbrëmje: "O Zoti im, kërkaj mbrojtjen Tënde nga brengat dhe dëshpërimi, nga paaftësia dhe dembelizmi, nga kopracia dhe frika, si dhe nga zhytja në borxhe dhe mundjet, padrejtësitë e njerëzve". Ebu Umame thotë, e kryeva porosinë e Profetit dhe Zoti ma largoi stresin dhe ma shleu borxhin).

NUHU

PROFETI I PARË I DËRGUAR NË TOKË

TË VEÇANTAT E TIJ SI PROFET, E VËRTETA RRETH FAMILJES SË TIJ, GRUAS DHE DJALIT PABESIMTAR

Nuh ibn Lamik është profeti i parë i dërguar në Tokë. Lindja e tij ishte 126 vjet pas vdekjes së Ademit. Këtë e mbështet edhe transmetimi i Buhariut nga Ibn Abasi) i cili ka thënë: “Mes Ademit dhe Nuhut janë 10 shekuj dhe të gjithë njerëzit jetonin në fenë islame. Zoti e dërgoi Nuhun (alejhi selam) tek njerëzit kur ata filluan adhurimin e idhujve e putave dhe humbën rrugën e drejtë të adhurimit të Zotit. Pikënisja e humbjes, ishte zbulimi i Shejtanit për adhurimin e idhujve. Në komentin e Fjalës së Zotit:

“... dhe thanë: ‘Mos i lini kurrsesi zotat tuaj! Mos e lini kurrsesi as Veddin, as Suvain, as Jeguthin, as Jaukën, as Nesrin!’ (Nuh 23)

Ibn Abasi ka thënë: “Këto janë emrat e besimtarëve të mirë nga populli i Nuhut. Pas vdekjes së tyre, Shejtani frymëzoi tek populli tyre që të ngrinin statuja për ta tek mexhliet e ligjëratave, ku secilës statujë i vendosnin emrin përkatës. Ata e vunë në jetë propozimin djallëzor, por fillimisht nuk iu dedikonin adhurim atyre.

Kur kjo gjeneratë ndërroi jetë, dhe njerëzit hoqën dorë nga kërkimi i diturisë, atëherë këto statuja filluan të adhuroheshin. Profeti Nuh i ftoi në adhurimin e vetëm të Zotit, pa i vënë shok në adhurim dhe braktisjen e adhurimit të zotave të tjerë përveç Tij. I ftoi, natën dhe ditën, hapur dhe në fshehtësi, mirëpo nuk e pranuan ftesën vetëm se disa njerëz.

“Ai tha: “O Zoti im, unë e thirra vërtet popullin tim natë e ditë, por thirrja ime edhe më tepër i largoi (nga e vërteta).

Sa herë, që i thirrja për t’i falur Ti, ata shtinin gishtërinjtë në veshë dhe mbuloheshin me petkat e tyre, duke këmbëngulur me mendjemadhësi (në mosbesim).

Pastaj i thirra me zë të lartë. Më pas ua shpalla edhe botërisht, edhe fshehurazi.” (Nuh 5-9)

Profeti Nuh përdori çdo mënyrë dhe formë, me shpresën që të pendohen nga adhurimi i zotave të kotë dhe statujave të ngurta e të pashpirt dhe t’i kërkonin falje Zotit, mirëpo pjesa dërrmuese e tyre vijuan në rrugën e humbjes dhe të shirkut.

Ata nuk u mjaftuan me kaq, por u ngritën kundër profetit Nuh (alejhi selam) me tallje dhe përqeshje në format më



poshtëruese dhe përbuzëse:
“Ne ia dërguam Nuhun popullit të tij e ai u tha: “O populli im! Adhuroni Zotin, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij! Unë kam frikë se do të bjerë mbi ju dënimi i një Dite të madhe!” Paria e popullit të tij tha: “Ne të shohim ty në humbje të qartë”.

Ai tha: “O populli im! Unë nuk jam në kurrfarë humbjeje, por jam i dërguar nga ana e Zotit të gjithësisë! Unë ju sjell shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj dhe di nga Zoti atë që ju nuk e dini. (Arafë 59-62)

Nuhu qëndroi mes tyre me përkushtim dhe sakrificë duke i ftuar në udhën e drejtë dhe duke iu kujtuar Zotin për një periudhë kohore mjaft të gjatë; 950 vjet.

Kur kaloi një kohë shumë e gjatë dhe profeti Nuh i humbi shpresat nga pendimi i popullit të tij nga shirku (Idhujtaria) dhe duke parë se populli i tij vazhdonin të zhytur në mëkate, kokëfortësi, mospranim të së vërtetës, ata e sfiduan duke i kërkuar t’ju sjellë ndëshkim:

Ata thanë: “O Nuh, ti na kundërshtove ne, madje e zgjate kundërshtimin. Le të na godasë ajo me çfarë na kërcënon, nëse thua të vërtetën!” (Hud)

Në këtë kohë Nuhu iu lut Zotit kundër tyre dhe duaja e profetëve është nuk kthehet mbrapsht:

“Dhe Nuhu tha: “O Zoti im, mos lër mbi tokë asnjë femohues, sepse, nëse Ti i lë, ata do t’i shpien në humbje robërit e Tu dhe do të lindin vetëm kriminelë dhe jobesimtarë!” (Nuh 26-27)

Zoti nuk vonoi dhe ia pranoi lutjen të dërguarit të tij:

“(Kujtoje) Nuhun kur ai Na thirri më përpara, dhe Ne iu përgjigjëm atij, duke e shpëtuar atë dhe familjen e tij nga mjerimi i madh (mbytja).” (Enbija 76)

Pas kësaj, Zoti e urdhëroi profetin Nuh që të ndërtonte një anije, sepse ky popull do të përfundonte i zhytur në ujë. Zoti i tërhoqi vëmendje Nuhut, që të kërkonte nga populli i tij që të pendoheshin përsëri, sepse dënimi tashmë ishte bërë fakt i kryer dhe i pakthyeshem:

“Dhe Nuhut iu shpall: “Nga populli yt askush nuk do të besojë, përveç atyre që tashmë kanë besuar, andaj mos u pikëllo për atë që bëjnë ata!

Ndërto anijen nën Sytë (mbikqyrjen) dhe udhëzimin Tonë dhe mos m’u drejto më për ata që janë keqbërës! Ata, me siguri, do të fundosen.” (Hud 36-37)

* Kur filloi ndërtimin e anijes, populli i tij filluan të talleshin me të:

“Ai nisi të ndërtonte anijen. Sa herë që kalonte pranë tij paria e popullit të tij, e përqeshte. Ai u tha: “Nëse ju talleni me ne, edhe ne do të tallemi me ju, ashtu si po talleni ju.” (Hud 38)

Sapo përfundoi ndërtimi i anijes, Zoti e urdhëroi profetin e tij, Zoti e urdhëroi që të marrë me vete çdo çift nga secila kafshë, shpend, etj, me qëllim vazhdueshmërinë e ekzistencës tyre.

“Kur arriti urdhri Ynë e uji nisi të gufojë nga sipërfaqja e tokës, Ne i thamë: “Ngarko

në anije nga çdo lloj gjallesë nga një çift, familjen tënde - përveç atyre kundër të cilëve ka qenë fjala e dënimit - dhe besimtarët!” Por shumë të paktë ishin ata që i kishin besuar atij!” (Hud 40)

Çfarë ndodhi pas kësaj? Zoti e përshkruan këtë katastrofë në një mënyrë prefekte.

“Dhe Ne i hapëm dyert e qiellit me ujë të rrëmbyeshëm dhe i shpërthyem burimet e tokës, e u takuan ujërat për një qëllim të paracaktuar.

Ndërsa Nuhun e bartëm në një barkë (të ndërtuar) prej dërrasash dhe gozhdësh, e cila lundronte nën Sytë Tanë: si shpërblim për atë (Nuhun) i cili u mohua.

Ne e kemi bërë atë si shenjë, por a ka kush që ia vë veshin?

Eh, sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia!” (Kamer 11-16)

Shiu zbriste nga qielli, uji dhe burimet shpërthenin nga Toka, derisa Zoti fundosi të gjithë përgënjeshtuesit me drejtësinë e tij dhe shpëtoi Nuhun dhe besimtarët, në sajë të mëshirës së tij, prandaj vetëm prej Tij është begatia dhe vetëm Atij i takon falenderimi.

Pas përmbajtjes dhe fundosjes totale të popullit të Nuhut, përveç besimtarëve prej tyre, nga të fundosurit ishte edhe bashkëshortja e tij, sepse ishte mohuese, jobesimtare. Zoti e ka përmendur çështjen e saj duke thënë:

“Zoti ka dhënë si shembull për ata që nuk besojnë, gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato ishin të martuara me dy nga robtë Tanë të ndershëm dhe i tradhtuan

ata. Prandaj, ata nuk mund t'i mbrojnë aspak nga Zoti (Ditën e Gjykimit) e atyre të djave do t'u thuhet: "Hyni në zjarr, me ata që po hyjnë!" (Tahrim 10)

Tradhëtia në këtë varg kuranor, ka për qëllim mosbesimin e profecisë dhe mospasimin e profetit dhe qëndrimi në mohim.

I biri i Nuhut, Jami, refuzoi të hypte bashkë me babain e tij në anije. Zoti ka thënë:

"Dhe ajo lundronte me ata nëpër valët e mëdha e të larta sa malet, ndërsa Nuhu thërriste birin e vet, i cili ishte ndarë veç: "O biri im, hip me ne e mos u bëj me mohuesit!"

(I biri) tha: "Unë do të strehohem në një mal i cili do të më ruajë nga uji". Nuhu iu përgjigj: "Sot askush nuk do të kursehet nga dënimi i Zotit, përveç atij që e mëshiron Ai!" Një valë në mes tyre i ndau dhe ai u fundos." (Hud 42-43)

Zoti e urdhëroi të dërguarin e tij, Nuhun, që kur të hypnin mbi anije dhe të qëndronin sipër saj të thonin këto dua, të cilat vijnë si kuptim i tekstit të disa vargjeve kuranore:

"Kur të hipësh në barkë ti dhe ata që janë me ty, thuaj: "Qoftë lavdëruar Zoti, i cili na shpëtoi prej popullit keqbërës"

Dhe thuaj: "Zoti im, më zbarko në vend të bekuar, se Ti je më i miri për të na zbarkuar."(Muminun 28-29)

Kur mbaroi caktimi i Zotit dhe përfundoi përmbytja dhe zullumqarët keqbërës u fundosën në formën më ndëshkuese dhe më të dhimbshme, Zoti urdhëroi

qiellin që të ndalojë shiun dhe Tokën që të përpijë ujin:

"Më pas, një zë thirri: "O Tokë, gëlltit ujin tënd dhe ti, o qiell, ndaloje (shiun)!" Dhe uji u tërhoq e u plotësua urdhri (i Zotit).

Ndërsa anija u ndal në malin al Xhudij dhe u tha: "Larguar qofshin

keqbërësit (nga mëshira e Zotit)!"(Hud 44)

Më pas Zoti i dha urdhër Nuhut (alejhi selam) që zbresë në tokë shëndosh e mirë dhe me begati.

"Atëherë iu tha: "O Nuh, zbrit me përshëndetje prej Nesh dhe me bekime për ty dhe pasardhësit e atyre që gjenden me ty.

Disa popujve (pasteje), Ne do t'u japim kënaqësi e pastaj do t'i godasë nga Ne dënimi i dhembshëm!" (Hud 48)

Anija qëndroi sipër Xhudiut, një mal i njohur në gadishullin arabik ¹⁾. Kur Nuhu zbriti bashkë me ata që ishin në anije, iu lut Zotit që të shpëtonte të birin e tij nga përmbytja dhe fundosja, sepse Zoti i kishte premtuar që do ta shpëtonte bashkë me familjen e tij:

"Pastaj Nuhu iu lut Zotit dhe i tha: "O Zoti im, biri im është nga familja ime, premtimi Yt është i vërtetë dhe Ti je Gjykatësi më i drejtë!"

(Zoti) tha: **"O Nuh, ai nuk është nga familja jote, ai ka bërë punë të keqe. Mos më pyet për atë që ti nuk e di. Unë të këshilloj që të mos bëhesh nga të paditurit".**

(Nuhu) tha: **"O Zoti im, mbështetem tek Ti për Të të mos kërkuar gjëra, për të cilat nuk kam dijeni. Nëse Ti nuk më fal dhe nuk më**

mëshiron, do të jem nga të humburit". (Hud 45-47)

Zoti tregoi se djali i Nuhut, edhe pse ishte nga gjaku i tij, këmbëngulja e tij për të qenë politeist, ia hoqi të drejtën për t'u emërtuar pjesë e familjes profetike.

Kjo do të thotë se familje e vërtetë e besimtarit, pa anashkaluar detyrimet ndaj familjes biologjike, është ajo që i përket besimit të pastër në Zotin e vërtetë.

Nuhu menjëherë kërkoi falje prej Zotit për këtë lutje e cila nuk ishte bazuar në njohuri dhe dituri të saktë.

Kur Nuhu iu afrua vdekja i tha të birit: "Do të të lë testamentin; të urdhëroj të veprosh dy gjëra dhe të kërkosh që të largohesh nga dy të tjera;

Të urdhëroj të thuash fjalën: La ilahe il-lallah, sepse nëse shtatë qiejt dhe shatë tokat do të viheshin në një rënë anë të peshores dhe fjala La ilahe il-lallah në anën tjetër, fjala "La ilahe il-lallah" do të peshonte më shumë.

Nëse shtatë qiejt dhe shtatë tokat do të ishin si një hallkë e fortë, fjala La ilahe il-lallah dhe Sub-hanallahi ue bi hamdihi, do t'i shkatërronte. Ato janë namazi i çdo gjëje dhe për shkak të tyre Zoti ju jep rizkun.

Ibn Ab-basi (Zoti qoftë I kënaqur me të), ka thënë: "Kur Nuhu u dërgua profet, mosha e tij ishte 480 vjeç, dhe pas përmbytjes jetoi edhe 350 vjet tjera."

Ibn Kethiri në komentim të fjalës së Tij thotë: "Nëse ky transmetim është i saktë, kjo do të thotë se ai ka jetuar 1780 vjet." por Zoti e di më së miri!

Kur gjuha flet atë që është e ndaluar



Në diskutim qëndron rreziku, ndërsa në heshtje siguria e cila është edhe enigma e diturisë. Heshtja reflekton në qetësi e dirjitet duke të ofruar hapësira për persiatje, ndaj është dhe aq e lavdëruar. I mundëson njeriut t'i përkushtohet dhikrit apo ibadetit e kështu të lirohet nga mbërthimi me gjemba i fjalëve të kota në këtë botë dhe përgjegjësia në Ditën e Gjykimit.

Zoti e krijoi njeriun në pamjen më të bukur, më pas e frymëzoi me dritën e besimit dhe me të e zbukuroi dhe e stolisi, e mësoi të flasë e të dallohet prej saj dhe e furnizoi me gjuhë, në mënyrë që të shprehë atë që e ka në zemër dhe mendje.

Gjuha është një nga begati të madhore të Zotit, të cilën ia dhuroi njeriut. Ndoshta mund të duket e vogël nga madhësia, mirëpo për nga bindja dhe mëkati është shumë e madhe. Aty gjendet besimi dhe mosbesimi. Vepra më e mirë dhe mëkati më i madh shfaqen pikërisht nëpërmjet gjuhës.

O motra ime, dua të sjell në mendimet tona atë që unë dhe ti apo kushdo tjetër, të cilit Zoti ia ka mundësuar mirësinë e madhe të komunikimit gjuhësor, që të bëjë kujdes në të folur, me gjuhën e tij, pasi të folurit e tepërt është helm i zemrës dhe fatkeqësi e gjuhës. Ta ruajmë këtë dhuratë që as shitet e as bilhet sepse, po nuk i vendosëm vetë kufinj të e po nuk i mbajmë të shtrënguar frerët, pasojat do të jenë të rënda. Askush nuk mund të na ndihmojë ta ndalim karrocën që depërton drejt të tatëpjetës për të mos u rrëzuar, e as të na garantojë që do të shpëtojme nëse biemë, e aq më pak të ngrihemi përsëri në këmbë. "Me të vërtetë robi, edhe pa menduar çfarë do të thotë, mund të shqiptojë fjalë për të cilat do të futet në zjarr më thellë nga çfarë është largësia ndërmjet lindjes dhe perëndimit"- thotë i dërguari i Zotit. Kjo, ngaqë ne vetë ia nënshtrojmë gjuhën shumë sëmundjeve. Me të ne shpesh bëjmë mëkate, gënjejmë, bëjmë thashetheme, bartim fjalë, mburremi, bëhemi hipokritë, ngjallim dyshimin,

ngatërrojmë të tjerët, shtrembërojmë kuptimin dhe fjalët, shqetësojmë të tjerët, fyejmë, e shumë të tjera, pa fund, çdo ditë, në çdo bisedë. Thotë Zoti në suren "Kaf", në ajetin e 18-^{le}: - "Ai (njeriu) nuk e shqipton asnjë fjalë, e që pranë tij të mos jetë prezent ai që vigjëlton"

Dikur, në të shkuarën apo mbase dhe në të tashmen, ka ndodhur që ne të kemi folur keq për motrën tonë, kur punët tona nuk shkonin ashtu siç ne dëshironim, apo kur ajo çfarë na thanë, nuk na pëlqeu dhe krejt papritur e pa menduar urrejtja shpërthen nga buzët ndërsa smira na e pushton zemrën dhe më e ulëta, dëshira për vetëlartësim na bën ta nënçmojmë e të shpifim për të, apo të hamendësojmë me pa të drejtë ndaj saj. E akoma më keq vazhdojmë duke nxjerrë të fshehtat që na i kanë besuar, t'i vëmë në dukje të metat që mund të kenë e t'i prekim në pikat e tyre të dobëtë. Po kështu, kur të tjerët hedhin baltë mbi motrën tonë, ne na mungon guximi për të thënë të vërtetën, heshtim kur nuk duhet, nuk ngrihemi prej aty as që bëhet fjalë për ti këshilluar!

Pse ngurojmë?! Pse vallë heshtim?! Hezitojmë t'i kundërvihemi apo t'i ndërpresim! Çfarë na pengon? Mos vallë dhe ne vetë nuk e duam? Ku është dashuria për hir të Zotit?! Aty, jeton frika se mos hidhërohen me ne, se mos na braktisin, se humbim shoqërinë e tyre, se...?! Dhe e vazhdojmë lojën e tyre! Dhe i bëjmë veshët tanë dëshmitarë të këtij mëkati kaq të madh. Ku janë fjalët e Zotit dhe të dërguarit të Tij? Çfarë po ndodh me ne, me besimin tonë?! Dhe atëherë kur këto ndodhin, shejtani vihet në punë më shumë se kurrë, duke tërhequr dhe udhëhequr nga të dëshirojë dhe si të dëshirojë ai, derisa e çon robin buzë humnerës dhe e shtyn në shkatërrim.

Profeti ynë, paqja e Zotit qoftë me të na tregon se: "Mysliman është ai nga gjuha dhe dora e të cilit janë të qetë mysliamanët e tjerë". Vallë sa mysliamanë e ndiejnë në vetene tyre të qetë nga ky hadith! A mundet që të mendojmë në ndërgjegjjen tonë të fshehtë e me pastërti, se nga gjuha dhe veprat që bëjmë, vëllai e motra jonë, janë të pa prekur e të sigurtë prej gjuhës sonë?! A janë të tjerët të qetë?! Si do të përgjigjemi para Zotit kur të pyetemi për atë që kemi vepruar?!

Thonë se tek njeriu i mençur, gjuha është pas zemrës, ndaj kur dëshiron të thotë diçka, së pari e mendon mirë. Nëse kjo do të jetë e dobishme, atëherë e thotë dhe në të kundërt, ai hesht. Ndërsa tek i padituri zemra është pas gjuhës. Ai flet sa herë i teket duke mos menduar fare.

Profeti na ka këshilluar: - "Kush e beson Zotin dhe Ditën e Gjykimit, të flasë të vërtetën ose të heshtë"

Sa të dobët dhe të pakujdesshëm që jemi! As që e vëmë në dyshim se të tjerëve gjithmonë ua gjejmë mëkatet, ndërsa mëkatet tona i lëmë pas dore dhe i harrojmë. Në syrin e vëllait tonë e shohim fijen e kashtës e në syrin tonë nuk e vërejmë trarin. Sa e vogël është drejtësia jonë dhe sa e madhe është padrejtësia jonë!

"Le të dëgjojnë veshët mirë çfarë thotë gjuha sepse na janë dhënë dy veshë dhe një gojë, që të dëgjojmë më shumë se të flasim", -thotë Ebu -Derda, ndërsa El- Hasanin, thotë: - "Kush nuk e ruan gjuhën e tij, nuk e kupton as fenë e vet".

E pra, le të tregohemi të kujdesshëm e të matur me gjuhën e mprehtë dhe të flasim vetëm gjëra që janë në dobi të krijesave të Zotit kur bisedojmë dhe të mos bëhemi si ata që nuk besojnë. Ta vërtetojmë frikën ndaj Zotit dhe ruajtjen e vetes ndaj ndalesave të Tij. Të nxjerrim vetëm mjaltë nga goja ose të heshtim nëse ajo çfarë përcillet është e dëmshme për ne dhe të tjerët në dynja e ahiret. Në këtë botë, me fjalë dhe vepra, mbjellim punë të mira dhe të këqija, frytet e të cilave do t'i korrim Ditën e Gjykimit. Nëse këtu mbjellim mirësi, atje do të korrim respekt. Por, nëse këtu me veprat që bëjmë dhe fjalët që i themi mbjellim prapësi, ajo që do të korrim atë ditë të madhe e vendimtare

për lumturinë apo vuajtjen pa fund, do të jetë pa diskutim vetëm pendimi, por edhe ky pa vlerë pasi është shumë vonë.

Me të vërtetë, bukuria e besimit tonë, gjendet në mosinteresimin me gjëra që nuk kanë të bëjnë me ne. Këtë e ka thënë vetë profeti, paqja e Zotit qoftë me të: - "Në bukurinë e besimit të njeriut (Islamit), bën pjesë edhe mosinteresimi me gjëra që nuk kanë të bëjnë me të". Sikur ta kujtonim fjalën para se ta nxirrnim, se çdo të thotë ta përgojosh vëllain apo motrën tënde edhe në gjumë do të na neveritej, aq e pështirë është sa që Zoti në suren "El-Huxhurat" ajeti i 12-^{te} thotë: - "...dhe mos përgojoni njëri- tjetrin! Vallë, ndonjëri prej jush do të kënaqej ta hante mishin e vëllait të vet të vdekur, - ndërkaq që juve ju vie vështirë, prandaj kini frikë Zotin, Zoti me të vërtetë pranon pendime dhe është mëshirues".

Mos harro, se nga përgojimi i vëllait apo motrës tënde, merret hidhërimi dhe urrejtja e Zotit dhe veprat tona të mira i shkojnë atij, të cilin e kemi përgojuar e nëse nuk kemi vepra të mira, atëherë mëkatet e atij, të cilin e kemi përgojuar barten mbi ne. Ai që e di këtë, thellohet në kuptimin e saj dhe mbërrin në përfundimin shkatërrues të saj, nuk ia lejon gjuhës dhe vetes bartjen e përgojimit. Por, nëse kjo ndodh, dhe biemë në sprovën e përgojimit, të kujtojmë të metat tona dhe të merremi me to, të provojmë t'i pastrojmë e t'i ndreqim.

Nëse me të vërtetë e duam këtë fe dhe e besojmë këtë, le ta ruajmë atë duke filluar së pari nga vetja. Sepse, bartja e fjalëve të huaja dhe përhapja e tyre në mesin e njerëzve ka si qëllim ngritjen e çrregullimit, përçarjes, grindjes dhe urrejtjen. Kjo është një nga vetitë më të këqija që njeriu mund ta posedojë, e cila nxit huti, këput lidhjet, mbjell urrejtje, shkatërron bashkësitë, miqtë i kthen në armiq dhe vëllezërit në të huaj. Ai që e bën këtë është si ajo miza e cila mbart me vete virusin e një sëmundjeje të rëndë.

O njeri i shkujdesur! Ki kujdes për veprat e tua. Dhe sërisht, ki kujdes për veprat e tua! Ki mendjen në çfarë gjendjeje do të dalësh para Krijuesit tënd! Ki kujdes ndaj ndalesave të Zotit dhe do të jesh i devotshëm e i shpëtuar.

Në bukurinë e besimit të njeriut (Islamit), bën pjesë edhe mosinteresimi me gjëra që nuk kanë të bëjnë me të".



"Kush e beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit, të flasë të vërtetën ose të heshtë"



"Me të vërtetë robi, edhe pa menduar çka do të thotë, mund të shqiptojë fjalë për të cilat do të futet në zjarr më thellë nga çështë largësia ndërmjet lindjes dhe perëndimit"-



Edhe kur në këtë jetë gjithçka të duket bardh e zi, mos harro se shumë dimensionalet gjenden diku, përreth teje. Ndonëse ti nuk i sheh mos mendo kurrë se nuk janë. Mjafton thjesht t'i kërlesh, të marrësh iniciativën për të rrënuar mbi realitetin, mbi jetën e përditshme, mbi atë që ne shohim vërtet sot, mbi atë që ndjejmë e na bën të jemi vetvetja.

Shpesh rri e mendohem për mënyrën se si ne sillemi, flasim me njeri-tjetri dhe gjithmonë dal në përfundimin se shoqëria në të cilën ne jetojmë, ende nuk ka arritur të krijojë atë botën e qetë të mirëkuptimit, tolerancës e për më tepër paqes. E kuptoj gjithmonë e më shumë faktin se jo të gjithë jemi njësoj, të paktën jo të gjithë tregohemi si të barabartë mestë barabartëve. Zoti kur e krijoi qënien njerëzore, e përfytyroi atë si individin me parime e vlera të rrënjësura thellë në përbërjen e tij. Njerëzit lindën të barabartë, por çuditërisht e njëkohësisht për fatin e keq tonin, filluan të marrin drejtime të ndryshme.

Me kalimin e kohës, sinjeriteti, çiltërsia, naiviteti, dashuria që kishin njerëzit për njëri-tjetrin evoluon duke u kthyer në të anasjellta jo fort të këndshme. Synimi kryesor u bë ai që të jesh "mbi"të tjerët, e të mos ndjehesh kurrësi i mposhtur. Arroganca dhe ambicia i shndërruan krijesat dikur të pafajshëm, në vrasës të ndërgjegjes, të po asaj ndërgjegjeje që ato mbartnin. E kush më mirë se ne di të mbërthejë të vërtetat e dhimbshme?!

Përse vallë i drejtohem negatives kur pozitivitetin mund t'a gjejmë në mjaft anë të mirëfillta të karakterit tonë? Si ka mundësi që pabarazinë qoftë atë gjinore, racore, fetare, atë të ngjyrës e kulturës e kemi para syve e nuk kemi guxim ta kundërshtojmë? Ne u bëmë bashkëpunëtorë, u bëmë miq, gjetëm vetveten në mospranimin e grupeve shoqërore e kjo ndodhi padyshim si pasojë e mënyrës së verbër vepruese po të këtyre njerëzve racistë.

Mirësjellja, dashuria, vlerësimi u zëvendësuan tani me ndjenjat e egoismi, urrejtjes, zilisë që

na rrethon më së shumti. Jeta na ka dhuruar shumë të mira, të bukura madje edhe të këqija që na bëjnë të reflektojmë, t'i kristalizojmë më shumë situatat, por kemi qenë me ata të pagabueshit, të paarritshmit dhe mbase jemi ne ata që nuk duam ta kuptojmë, atë botën përtej së bukurës, atë realitetin e vërtetë. Atë botën e pakuptimtë të të varfërve, të lypësve, jetimëve, atyre fëmijëve dhe të mohuarve pa shpresë. Ne jemi rritur mes së mirës, respektit, tolerancës, dashurisë së dhuruar nga familja e të afërmëve të tjerë, pordhe mes ndjenjave negative, që shpeshherë na kanë bërë konfuzë për të tashmen e për të ardhmen.

Pa mëdyshje mund të them se shpesh jeta që ne kërkojmë nuk vjen në atë formën e përsosur që ne duam. Thjeshtë na duhet diçka për të kuptuar botën e dhembshur. Fare thjeshtë mund të reflektojmë me anë të një shembulli të rëndomtë.

Teksa kaloj një ditë në qytetin tim, dora e vockël dhe e vobektë e një lyspari jetim, me një fytyrë të pashpresë, me sy

barabartë...



ZËRI IM

ndryshme...

të trishtë zgjatet në atë sensin e padjallëzuar femënor drejt një burri të ashpër në fytyrë. Si gjithmonë përbuzja i kalon kufinj të dhe dashamirësia e burrit në fjalë të shumë për të dëshiruar.

Sa jetë të ndryshme ! Lypsi i vogël, i veshur me disa rrecka e i uritur pa masë, e njeriu mizor i veshur me një kostum të pastër nuk ndaloi pa fare mëshirë. Ai ecën drejt duke shikuar shtrëmbër, sikurse nuk ka parë asgjë. A vallë një hije drite nuk mund të përcojë krenarinë e këtyre njerëzve kopracë e të pamëshirshëm?!

Drejtohem rreth krijesës së pafajshme dhe lotët e tij hynë thellë në dhembshurinë që ndjej për njerëzimin. Ne jemi të njejtë të ftohtë e minor, por femija i braktisur në mëshirë të fatit nuk është i tillë. Ai shpesh është i uritur, në dimër ka ftohtë e një strehë qëndrimi nuk ka. Përkujdesje e dashuri nuk merr nga askush. Kjo është bota ku ne duhet të përcjellim dashuri, ku jo çdo ditë lind diell e shpesh retë e zymta vrasin shpresa, ëndërra e jetë.

JONIDA DERJAJ – ÇMIMI I, KAVAJË

Jeta është një sferë e kristal të që zbret nga qielli është dhuratë e shenjtë dhe përgjegjësi e madhe. Që t'i japësh asaj vlerën që i takon duhet të dish ta ruash, ta mbrosh, dhe kultivosh. Jeta karakterizohet nga brishtësia dhe ekspozimi i saj ndaj së keqes, e bën më të rrezikuar dhe më të vështirë detyrën për ta mbrojtur atë. Ne vijmë në këtë jetë të barabartë dhe marrim prej Zotit të njëjtën dhuratë, por gjatë rrugës ndodh diferencimi, dikush zgjedh rrugën e drejtësisë, dikush të epërsisë dhe dikush tjetër të nënshtrimit. Kështu ndahen rrugët e jetës dhe rruga e drejtë për fat të keq është pak e populluar, pasi njerëzit të joshur nga e liga kanë zgjedhur rrugën e gabuar.

Mashkullit i pëlqen dominimi dhe i karakterizuar nga egoizmi personal, kërkon të ketë epërsi mbi seksin femër. Femra, qenia sociale e ardhur në këtë botë ashtu si mashkulli, historikisht përpiqet të gjejë vendin e saj dhe në luftën e vazhdueshme për prioritet, ajo mund të ketë fituar vetëm disa beteja, pasi ende vazhdon të paragjykohet,

ende vazhdon të diskriminohet dhe t'i mohohen të drejtat. Kjo nismë e ndërmarre prej kohësh dhe kjo temë kaq e diskutuar dhe aktuale vazhdon të jetë e hapur ende edhe sot edhe pse jeta në tokë ka festuar mijëvjeçarët e saj. Nuk mund të themi se s'ka pasur progres, pasi kohave të është progresiste, por ndryshimi ecën me hapa të ngadalta dhe vonon të vijë, ndaj o njeri, ti që u lodhe nga pritja ngrije zërin dhe guxo, hape zemrën dhe kërko të drejtat e tua.

Në këtë botë ka vend për ty, për mua e për të gjithë. Kjo është bota e të gjithëve dhe e gjithçkaje, ndaj për të mbijetuar të duhet të luftosh për të mbrojtur vendin tënd dhe të drejtat e tua. Liria e tjetrit duhet të mbarojë aty ku fillon e jotja e kështu jeta merr vlerën e saj dhe ne do të jetojmë në një botë më të mirë. Kështu të gjithë mund të ndihemi krenarë dhe fitimtarë, sepse unë besoj se nga kjo jetë mund të dalësh si fitues ose si humbës dhe kjo varet nga ty, nga rruga që ti zgjedhe për të dalë.

ELONA FISHEKU – ÇMIMI I, FIER 21

Gjithçka ndodhi, kur unë isha fare i vogël, ende pa u ndarë mirë nga krahët e ngrohtë të nënës sime të shtrenjtë, aq të dashur për çdo fëmijë, që ende nuk i ka mbushur tri vite të jetës së tij. Një fëmijë që akoma kërkon të struket nën krahërorin e ngrohtë të saj për të thithur aromën e saj, që të bën të lumtur teksa e ndjen. Aq isha unë atëherë, kur ty nuk të kisha më pranë, kur dëshira e një fëmije për t'u përkëdhelur në sy të prindërve të tij ishte arratisur. Ku dora e ngrohtë prej nëne nuk do të përkëdhelte më kokën e birit të saj e nuk do të rrëshqiste më mbi flokët e mi të butë, ku mungesa e ninullave më bëri, që gjumi të mos më zinte e që të më mungonte një vetvlerësim i mirë për veten dhe që gjithmonë më bëri të kisha turp, ndrojtje e frikë për çdo hap që hidhja teksa ngjitja shkallët e jetës, teksa rritesha. Unë nuk kisha e as që mundja se si ta kuptoja se ç'po ndodhte me ju, se përse jetonit të ndarë por, e ndjeja mungesën tënde dhe pyesja vazhdimisht se përse t'i mungoje në atë dhomë. E akoma më pak, nuk e kuptoja kur të tjerët vinin në shtëpi e flisnin për ty, ndërsa tek unë linte mendimi dhe dëshira e zjarrtë se t'i do të vije aty nga çasti në çast e do të më merrje me mall të më shtrëngoje fort në krahërorin tënd, e të më mbuloje me puthje pafund kudo, e të më këndoje ato këngë që aq bukur dhe që me aq dashuri nëna ia këndon djalit të saj të vetëm, fëmijës që për herë të parë e bëri nënë. Ndërsa unë do të mbështesnja kokën duke qeshur mbi krahërorin tënd e do të shtrëngoja fort, shumë fort që t'i të mos më lëshojë më nga ai përqaftim që shpreh aq shumë dashuri e dhimbshuri në marrëdhënien nënë e bir. Do të mbështetesha fort pas teje që të mos më zbrisje më nga prehri yt, që të mos më largoje nga vetja, që të mos ikje më... Ç'boshllëk i madh që u krijua tek unë, sa mall për ty e sa lot tek unë, çdhimbje për veten, për babain, për ty...!

Babai u mundua që të më qëndronte sa më pranë, bënte çmos që të më përcillte sado pak dashuri e ngrohtësi mëmësore, përpiquej që të kthente lumturinë në sytë e mi, mundohej që të më blinte lodra me ato pak të holla që merrte nga puna e tij që unë të mos mërzhitesha e të mos qaja duke të kërkuar ty rreth e rrotull nëpër shtëpi. Më nxirte shëtitje që unë të hutohesha, por gjithmonë e më shumë unë e ndjeja që shpirti më therte për gjithçka që ndodhte rreth meje, e akoma më shumë kur të gjithë fëmijët shoqëroheshin nga nënat e tyre e ato i shtrongojin fort për dore. Ndërsa thellë në zemrën time diçka pikonte, e sado që babai im i shtrenjtë bënte ç'të mundej që unë të rritesha si gjithë të tjerët nuk e arriti dot, sepse gjithmonë tek unë ishte ai boshllëku që nuk zëvendësohej me asgjë,

aty mungoje t'i o nënë e vetme dhe e pazëvendësueshme. Babai është baba e nuk mundet kurrë të bëhet nënë e as nëna nuk mund që të bëhet baba. Kështu, Zoti na ka krijuar.

Unë gjithmonë shpresoja e prisja pa u lodhur para derës së shtëpisë me vështrimin larg, atje në krye të rrugës se mos dëgjoja hapat e tu e të vrapoja drejt teje, se mos shfaqej hija jote..., por më kot...zemra veç sa dëshpërohej më shumë e asnjëherë nuk gëzonte, por vazhdonte të mpihej pa fund... Ah, sa lotë kam derdhur teksa prisja para portës së shtëpisë i vetëm në mes të lagjes, në ato netë të ftohta dimri kur babai vonohej në punë. Askush nuk më shikonte nga ndonjë cep i dritares së shtëpisë së tij që të më merrte e të më qetësonte "zemrën e plasur" me disa fjalë të buta, të m'i fshinte lotët që rridhnin në faqe, e të më ngrohte duart e mavijosura dhe trupin e ngrirë nga i ftohti. Sa i gjatë e i ashpër ishte dimri në shtëpinë tonë. Por, pranvera e vera trokasin në çdo shtëpi, ndërsa tek unë gjithmonë kishte veç vjeshtë të zymtë dhe dimër me stuhi.

Po ti, vallë a më ke ndjerë kaq thellë, a kish dimër tek ty, a kish shi e stuhi, po pranvera a erdhi me të vërtetë në zemrën tënde prej nëne? Vallë, a më kujtove mua kur hyra për herë të parë në kopësht? A mendoje për mua kur nisa klasën e parë? Mua më kujtohen shumë qartë këto ditë të jetës sime, ato lanë gjurmë të thella brenda krahërorit tim, në shpirtin tim, tek sytë e mi që gjithmonë përloreshin, në buzët e mia që kurrë nuk ditën të qeshin si çdo fëmijë, por veç një buzëqeshje e pikëlluar që dallohej qartë në mes të gjithë atyre brohorimave të gëzueshme që buronin nga çdo fëmijë tjetër, ndërsa tek unë zëri ishte i mbutur nga dhimbja. Sa "zili" për të tjerët, e akoma më shumë kur më ftonin në shtëpi dhe nëna e tyre na gatuante, na shtronte për të ngrënë, na mësonte se si të ishim djem të mirë e të

edukuar, na ndihmonte në mësimet e në fund më mbështillte diçka me vete e më përcillte për në shtëpi. Kurse unë nuk mund t'ia bëja diçka të tillë shokëve të mi. Për ta unë isha shoku i mjerë.

Nuk ishin disa ditë, por ishte pjesa e ndryshkur e jetës sime. Fëmijëria vjen veç një herë në jetë, nuk ndreqet më, nuk kthehet kurrë veçse në kujtesë e në ëndërra pa fund! Është fëmijëria ime...

Unë e di, nuk ishte dëshira jote që të mos më mbaje më në prehrin tënd e as e tim eti, e di që edhe ti ëndërroje dhe kishe shumë të drejtë të kërkoje ndoshta lumturinë e dëshiruar të një vajze njëzet vjeçareje diku tjetër. Jo, mos më keqkupto. Unë jam biri yt dhe të kam dashur e të dua shumë dhe ti gjithmonë do të jesh nëna ime, pavarësisht gjithçkaje, ti je nëna më e mirë në botë për mua. Por, sot dua që t'i tregoj atyre që se dinë se çdo të thotë fëmijëri e këputur nga dhimbja, atyre që abuzojnë me të, se sa e rëndësishme dhe e domosdoshme është të paturit e një familjeje të shëndoshë tek fëmijët e tyre.

Dijeni të gjithë se jeta për fëmijën me prindër të ndarë është si e një pulëbardhe që i kanë plagosur njërin krah e ajo kurrsesi nuk mundet që të fluturojë më në qiellin e pastër e të shndritur nga dielli i ngrohtë. Fëmija është si ajo bima, filiza e re, e njomë dhe e pastër që vyshket pa ujë e nga i ftohti dhe që nuk mundet të kthehet më.

Sot, unë jam vetë prind, falenderoj pafundësisht Zotin që më dha mundësinë që të ndërtoj familjen time të mrekullueshme dhe i lutem gjithmonë që të më ruajë mua dhe ato nga çdo gjë e keqe që mund të ndodhë. Unë lutem që biri im të mos përjetojë atë çfarë unë edhe sot e ndiej aq fort, e jo vetëm biri im, por asnjë fëmijë tjetër i kujtdo qoftë ai.

Unë gjithmonë jam e do të jem nga ata që e ruajnë me fanatizëm familjen e do të luftoj që ajo të jetë gjithmonë e bashkuar, larg dhimbjes, vuajtjes, ndarjeve ...

O krijesa të Zotit! Gëzojini familjet tuaja, bashkëshortin apo bashkëshorten, prindërit e fëmijët tuaj, me dashuri e respekt, me buzëqeshje, dhurata e surpriza, gëzoni në shtëpitë tuaja dhe jini të drejtë me njëritjetrin.

Jeta ime u ndriçua kur unë gjeta paqe tek Krijuesi ynë, pranvera erdhi kur ti u ktheve e prekshme tek unë, e trupi m'u ngroh kur Zoti më mundësoi që të kem shoqen time të jetës, një grua besimtare që i frikësohet Zotit e i përulet Atij, që kujdeset për familjen, shtëpinë e fëmijët tanë, e lulet çelën, kur Zoti më begatoi me fëmijë.





KAPRIÇOT, FËMIJËT PRINDËRIT &

Nga: ORIOLA HETA (VAROSI)

Shpesh i shikojmë kapriçot e fëmijëve tanë si aspak të rëndësishme. Por duhet kuptuar se kapriçot janë pjesë e botës së fëmijës. Të kuptohet kjo gjë nga të gjithë është shumë e vështirë. Nuk duhet harruar asnjëherë se fëmijët i përdorin kapriçot e tyre për t'u treguar probleme të rëndësishme prindërve të tyre. Por tekat gjithashtu janë pjesë e fëmijërisë se çdo fëmije. Është e rëndësishme që fillimisht të kuptojmë se çfarë kemi përballë e më pas të kërkojmë zgjidhje për këtë problem, që mbi të gjitha të jetë në të mirë të fëmijës. Kuptimi i kësaj është se për tu përballur me kapriçot (tekat) e fëmijës nuk ka një formulë të saktë e cila mund të shërbejë për të gjithë, por çdo rast është unik, ndaj duhet analizuar me kujdes pasi çdo fëmijë ka mënyrat e tij të ëe shprehurit.

NË ÇDO FAZË TË RRIJES, KA NJË KAPRIÇO TË VEÇANTË

Fëmijët rriten duke kaluar nëpër faza të rëndësishme, proces, i cili është i gjatë dhe i vështirë në të njëjtën kohë, pasi kërkon një përkushtim të madh nga të dy prindërit. Gjatë kalimit nëpër këto faza fëmijët fillojnë të ndërgjegjësohen për veten dhe botën që i rrethon nëpërmjet disa mekanizmave shumë të saktë. Secila nga këto faza karakterizohet nga situata dhe sjellje specifike për të cilat duhet të jemi të kujdesshëm sepse ndonjëherë i etiketojmë me të padrejtë si kapriço të fëmijëve tanë.

- 0 – 3 VJEÇ: Të flasësh për teka dhe kapriço në këtë moshë nuk është e drejtë. Fëmijët në këtë moshë nuk ngulin këmbë për gjëra të kota, por kërkojnë një vëmendje më të madhe nga prindërit, veçanërisht nga nëna e tyre. Kontakti fizik në këtë moment është shumë i rëndësishëm për të vendosur një raport për të cilin fëmija ka shumë nevojë dhe e ndihmon atë të krijojë besim dhe siguri tek vetja dhe tek të tjerët. Porë në këtë këndvështrim të qarat dhe të bërtiturat e një të sapolinduri janë tregues të rëndësishëm të nevojave të tij, ata qajnë kur kanë uri, kur kanë nevojë të ndërrohen, kur kanë frikë etj, ndaj nuk duhen parë si teka ose kapriço, por u duhet kushtuar rëndësi. Ndërkohë fëmija

po kalon nëpër fazën që nga psikologët quhet "stadi orale" dhe që zgjat deri rreth moshës 3 vjeç. Kapriçot e para gjatë kësaj faze mund të shfaqen në situata të tilla si preferencat për ushqimin apo gjatë procesit të të ngrënit (jo gjithmonë mund të ndodhë kështu, gjërat janë relative). Rreth moshës 2 vjeçare, fëmija dëshiron që të qëndrojë pranë nënës së tij, ndaj kapriçot gjatë kësaj kohe nuk janë gjë tjetër veçse tentativat që bën fëmija për tu afirmuar. Është detyrë e prindërve t'u kushtojnë një vëmendje të madhe këtyre situatave.

- 2 vjeç e gjysëm – 3 vjeç e gjysëm: Kemi përfundimin e fazës orale dhe vazhdimin me procesin e njohjes nga ana e fëmijës e të gjithë trupit të tij (jo vetëm të gojës). Fëmija gjatë kësaj kohe hyn në atë që quhet faza anale, gjatë se cilës ai kërkon të vendosë autonominë e tij. Kjo periudhë është quajtur ndryshe edhe periudha "opozitare" gjatë së cilës fëmija thotë gjithmonë "jo" duke përdorur agresivitetin që i karakterizon. Gjatë kësaj kohe dialogu dhe shprehja e dashurisë janë elemente të cilët do ta ndihmojnë fëmijën të kalojë këtë fazë të rritjes dhe zhvillimit të tij. Është moshë gjatë së cilës kapriçot fillojnë të bëhen më të shpeshta dhe shqetësuese për prindërit dhe familjarët e tjerë.

- Pas moshës 3 vjeçe gjysëm - 5 vjeçe: Gjatë kësaj periudhë të rritjes fëmijët fillojnë të përjetojnë konfliktet e para me prindërit e të njëjtit seks, të cilin fëmija e sfidon për të kuptuar dhe vendosur se cili është më i forti. Në të njëjtën kohë fëmija përpiqet të mbajë nën kontroll edhe çifitin (prindërit e tij), shpesh herë fëmija ndjehet i përjashtuar nga lidhja e prindërve të tij, pikërisht ky përjetim negativ, ai i përjashtimit mund të bëhet shkak për lindjen e kapriçove dhe kërkesave pa vend. Është detyrë e prindërve që ta ndihmojnë fëmijën të kalojë këtë situatë me sukses duke i shpjeguar rëndësinë dhe dashurinë që ata të dy kanë për të. Gjatë kësaj moshe kemi një intensifikim më të madh të kapriçove të fëmijëve.

GABIMET MË TË SHPESHTA TË PRINDËRVE

Janë prindërit ata që shpesh bëhen iniciatorët e situatave kapriçoze të fëmijëve duke:

- Menduar gjithmonë për pasojat e këtyre tekave dhe duke lënë jashtë vëmendjes shkaqet e tyre.

- E analizojnë situatën duke u nisur nga nevojat e tyre dhe jo nga ato të fëmijëve.

- Shpeshherë ata udhëhiqen nga ndjenjat e tyre të fajit dhe jo nga nevojat primare të fëmijëve .

- Prindërve u ndodh shpesh të mos i kuptojnë fazat e rritjes nëpërtë cilat kalojnë fëmijët e tyre. Faza gjatë të cilave fëmijët janë gjithmonë në kërkim të "formulave" për sjellje sa më të pranueshme dhe të vlerësuara nga prindërit.

- Fëmijët janë të ndryshëm, dhe mbi të gjitha reagojnë në mënyra të ndryshme në çaste zemërimi. Të gjithë prindërit duhet të tregojnë kujdes dhe të kenë parasysh faktin që, kur kapriçot dhe zemërimet janë të shpeshta diçka nuk shkon me fëmijën tuaj. Është koha për të kërkuar shkaqet e kësaj situatë dhe për të kthyer kokën pas.....mund të keni bërë ndonjë "gabim".

A KANË PRINDËRIT GJITHMONË TË DREJTË?

Detyra e prindërimit është shumë e vështirë, madje mund të themi me bindje të plotë që është detyra më e vështirë. Jo rrallë herë ndodh që edhe prindërit të gabojnë, në një situatë të tillë prindërit duhet të jenë të sigurtë me veten dhe më pas me fëmijën për gabimet e bëra. Madje këshillohet që këto gabime të pranohen para fëmijëve dhe të dikutohen me ta. Ajo që na shqetëson të gjithëve si prindër gjatë kapriçove të fëmijëve është elementi i agresivitetit, është e drejta e tyre të kundërpërgjigjen në momente të caktuara, nëse është kjo gjë që ndiejnë brenda tyre. Zemërimi duhet të "shpërthejë" të dalë jashtë (brenda kufijve të pranueshëm) jo vetëm për tu çliruar prej saj, por mbi të gjitha për të mirën e vetë fëmijës, që nëpërmjet këtij reagimi njih akoma më shumë veten e tij. Të mirëkuptosh kapriçot e fëmijës dhe domethënien e tyre nuk do të thotë që t'i japësh atij gjithmonë të drejtë, por është mënyra më e mirë për të vendosur me të një dialog që do t'i shërbejë si fëmijës dhe prindërve gjithashtu. Të gjithë prindërit duhet të kërkojnë dhe të gjejnë "çelësin" e duhur për të kuptuar tekat dhe kapriçot e fëmijëve të tyre, me qëllim që të kenë gjithmonë një marrëdhënie të shkëlqyer dhe të lumtur me ta. Por mbi të gjitha që të rrisin fëmije të shëndetshëm, bashkëpunues dhe tolerantë.





M J E K Ë S I

Fara e zezë

Habbetus-Seuda

“Përdorni rregullisht këtë farë të zezë, sepse ajo përmban në vetvete ilaç për çdo sëmundje, përveç vdekjes”. (thënie profetike)

<i>Nigella sativa Nigella sativa</i> Seleksionimi shkencor	
Kingdom:	Plantae
Mbretëria:	
Division: Tipi:	Magnoliophyta
Class: Klasa:	Magnoliopsida
Order: Rendi:	Ranunculales
Family:	Ranunculaceae
Familja:	
Genus: Gjinia:	<i>Nigella</i>
Species: Lloji:	<i>N. sativa N. sativa</i>
Emri botanik	
<i>Nigella sativa</i> lat. <i>Nigella sativa</i>	

Çfarë është fara e zezë?

Nigella sativa- Fara e zezë është një bimë njëvjeçare, me prejardhje nga Azia jugperëndimore. Ajo shkon 20-30 cm e gjatë, lineare. Lulet janë delikate dhe zakonisht me ngjyrë të zbehtë blu dhe të bardhë, me 5-10 petale. Fruti është një kapsule e madhe dhe e fryrë, e përbërë nga 3-7 folikula, ku secili përmban fara të shumta në formë trigonale. Farërat e saj përdoren si erëza dhe në mjekësi për të kuruar sëmundje të ndryshme.

Fara e zezë ka emra të ndryshëm. *Nigella Sativa* është emri i saj botanik që rrjedh nga latinishtja. Ajo është e njohur edhe si Kalonji (urdu), Kezah (hebraisht), Shonaiz (persisht), Habbat el Bereqet (nga arabishtja -fara e bekimit). Ndër muslimanët njihet me emrin Habbe Seuda. Në anglisht quhet lule kopër, qimnon i zi, lule arrëmyshku ose Korianderi grek. Në Gjermani njihet me emrin Schëarzkuimmel dhe Cörek Otu në Turqi. Ajo është quajtur shpesh farë e zezë qepe për shkak të ngjashmërisë së saj me farën e qepës, por ato nuk kanë asnjë lidhje me njëra-tjetrën. Disa gabimisht e quajnë edhe susam i zi. Më shpesh i janë referuar asaj me emrin *nigella sativa* ose fara e zezë. *Nigella Sativa* i përket familjes së bimëve të Ranunculaceae (familjes zhabinë). Fara e zezë ka pak erë, por kur bluhet ose përtypet ka një erë të turbullt si të rignonit. Ka shije aromatike dhe është pak e hidhur.

Historiku i saj

Farë e zezë ka një histori prej 2500 vjetësh. Kjo e bën farën e zezë një nga ekstraktet bimore më të sigurta për konsumimin njerëzor.

Nigella sativa është një nga farat mjekësore më të çmuara në histori. Farat e mira rriten në kushte gati të përsosura në oaze ku ata ujiten derisa të formohet mbështjellësja e farave. Sipas Zohary dhe Hopf, provat arkeologjike në lidhje me kultivimin e hershëm të *N. sativa* është ende i pakët, por ata raportojnë se farat *N. sativa*, janë gjetur në disa vende në Egjiptin e lashtë, duke përfshirë edhe varrin e faraonit Tutankhamun^[6]. Megjithatë roli i saj në kulturën egjiptiane është ende i panjohur. Edhe pse fara e zezë është përmendur në Bibël, si dhe në fjalët e Pejgamberit Muhamed a.s, ajo nuk ishte hulumtuar me kujdes deri në rreth dyzet vjet më parë. Që nga ajo kohë, më shumë se 200 studime janë kryer në universitete të ndryshme të botës. Mjeku i famshëm grek Dioscorides e përdorte farën e zezë për të trajtuar dhimbjen e kokës dhe dhimbjen e dhëmbëve.

Egjiptianët e vjetër e kanë njohur dhe e kanë përdorur farën e zezë dhe në papiruset e tyre e kanë përshkuar si farë botanike mjekësore. Romakët e kanë njohur gjithashtu këtë farë dhe e kanë quajtur farë koriandere greke dhe kanë përdorur si plotësuse dietetik.

Vaji i posaçëm që nxirret nga kjo bimë tashmë përdoret për përgatitjen e preparateve mjekësore.

Sot kjo bimë kultivohet nga Egjipti në Indi.

Ku përdoret?

Farë e zezë përdoret në parfumeri, veçanërisht në sapunë dhe si erëz në torta, bukë, pasta, ëmbëlsira, salca, djathëra, etj. Gjithashtu përdoret si aromatizues. Vaji yndyror i fituar nga shtypjave e farave përdoret për qëllime ushqimore dhe mjekësore. Vaj është gjysëm i thatë dhe në ngjyrë të kuqe në kafe. Ato përdoren gjithashtu edhe si një agjent stabilizues për yndyrnat ushqimore.

Farat e zeza janë të vogla. Ato mund të përdoren për të bërë çaj, thjesht duke derdhur ujë të ngrohtë mbi farat dhe duke i lënë për 10 minuta. Me një lugë gjelle me fara të zeza mund të bëjmë një filxhan me çaj të këndshëm, por është më mirë që filxhani të mbulohet me një copë deri sa të jetë e gatshme për ta pirë, në mënyrë që të mos i ikë aroma. Disa njerëz i shtojnë çajit të tyre të preferuar ose kafes disa fara të zeza dhe me imagjinatën e tyre sjellin në mendje imazhe të deveve dhe nomadëve. Farat e zeza mund të bluhën dhe të përzihen me mjaltë ose t'i shpërndash në sasi të vogla nëpër sallatra. Ato i japin shije sallatës sidomos kur kombinohet me limon. Farat e zeza të përziera me mjaltë dhe hudhër janë tonikë të shkëlqyer

për njerëzit me astmë ose kollë, si dhe për ata që duan të rrisin imunitetin e tyre gjatë sezonit të ftohtë të gripit, ose kur është duke iu shfaqur ndonjë infeksion.

Metoda e prodhimit të vajit të farës së zezë

A) Procesi i përpunimit

Niveli i lagështisë së farave reduktohet në mënyrë optimale nëpërmjet procesit të tharjes. Farat e zeza shtypen në mënyrë mekanike për të bërë vajin.

Vaji mbledhet në rezervuarin e mbledhjes pas filtrimit fillestar. Vaji transferohet në një enë të posaçme nga rezervuari i mbledhjes. Ky vaj transferohet pastaj në enë të veçanta dhe vaji filtrohet mekanikisht duke kaluar përmes një pajisje filtrimi. Vaji i filtruar mbledhet në disa enë të posaçme dhe ruhet në gjendje ajri të ngjeshur. Më pas vaji kapsulohet në kapsula xhelatine. Pas kapsulimit kapsula lahet, thahet pak, i kontrollon cilësia dhe dërgohet më pas për paketimin përfundimtar.

B) Procesi i kontrollit

Makieria rregullohet në mënyrë periodike gjatë procesit të përpunimit të farërava për të marrë prodhim optimal dhe cilësinë më të mirë të vajit. Ngjyra dhe era e vajit monitorohen periodikisht gjatë procesit. Në mënyrë periodike gjatë procesit të prodhimit merren mostra për të testuar parametrat fizikë. Vaji i filtruar testohet për të gjitha parametrat nëse ajo përputhet me parametrat e cilësisë së kërkuar. Kapsulat kontrollohen për ndonjë prishje të mundshme, për deformime dhe për madhësinë e tyre. Përbërja e këtij vaji realizohet sipas mënyrës së ftohtë konform kushteve optimale ndërkombëtare për të ruajtur elementët e tija të shumta aktive pa pësuar asnjë ndryshim në strukturën e tij kimike.

Nigella sativa është përdorur në shekuj në Azi, në Lindjen e Mesme dhe Afrikë si bimë dhe vaj i përpunuar, si dhe për qëllime mjekësore. Ajo është përdorur tradicionalisht për një shumëllojshmëri trajtimesh që kanë të bëjnë me shëndetin, kryesisht me frymëmarrjen, stomakun dhe shëndetin e zorrëve, funksionin e veshkave dhe mëlçisë, mbështetjen e qarkullimit të gjakut dhe të sistemit imun, si dhe për mirëqenien e përgjithshme. Në Islam, kjo konsiderohet si një nga format më të mira të mundshme të shërimit.

MJEKËSI PROFETIKE

Farën e zezë mund ta gjejmë të disponueshme në forma të ndryshme:

- 1- në formë vaji
- 2- në formë kapsule
- 3- në formë farash të paketuara në qese
- 4- në formë kremi
- 5- në formë pluhuri
- 6- në formë balsami
- 7- në formë pudre
- 8- në formë xheli



Secila prej këtyre llojeve mund të jetë e pastër pa përbërës të tjerë ose e përzier me përbërës të ndryshëm, ku secili produkt në varësi të përbërjes e ka të përcaktuar qartë se ku dhe për në çfarë sëmundje rekomandohet dhe kjo jepet në amballazhin ose në fletën shoqëruese që jepet së bashku me medikamentin.

Fara e zezë dhe vaji i saj është përdorur në shumë pjesë të botës për një kohë të gjatë, për shkak të dobive të saj në trajtimin e disa sëmundjeve dhe për shkak të përvojës së përdorimit në Azi, në Lindjen e Mesme dhe në vendet e Gjirit.

Produkte të shumta të përfuara nga farat e zeza prodhohen në Srilanka, Indi, Gjermani, në Mbretërinë e Bashkuar etj.

Kujdesi për bukurinë

Natyrisht para se të kujdesemi për bukurinë, ne duhet së pari të kujdesemi për shëndetin. Vaji i farës së zezë është përdorur nga Kleopatra dhe mbretëresha Nefertiti.

Vaji esencial i farës së zezë siguron pastrimin e lëkurës dhe ka cilësi purifikuese, dhe përmbajtja e saj e bën atë një hidratues të mrekullueshëm për lëkurën dhe flokët. Fara e zezë garanton rinovimin qelizave, forcimin e indeve lidhës, stimulon furnizimin me gjak të lëkurës duke arritur në këtë mënyrë një rigjallërim të kësaj të fundit.

Shembull: Përzieni ½ lugë çaji vaji të farës së zezë me ½ lugë çaji me vaj ulliri dhe aplikojeni në fytyrë duke evituar sytë. Lëreni për 15 minuta dhe më pas lajeni fytyrën me ujë të ngrohtë.

Ajo ç'ka është unike në lidhje me përbërësit e vajit të farës së zezë është se ai përmban 0,5 - 1,5% vajra esenciale të cilat e bëjnë atë të përkryer për të qenë një vaj masazhi aromaterapi. Nga ana tjetër shumë përdorime tradicionale të vajit tregojnë aplikimin e tij të jashtëm për kujdesin e lëkurës, siç janë aknet dhe psoriasis.

Nigella Sativa si medikament

Fara e zezë është një adaptogen që do të thotë një agjent që shkakton reagime adaptive. Fara e zezë ka aftësinë për të rritur rezistencën e trupit të njeriut dhe për ta mbrojtur atë kundër sëmundjeve të ndryshme. Hulumtimet klinike kanë treguar se vaji i farës së zezë kontrollon sasinë e sheqerit dhe të kolesterolit në gjak përveç shumë sëmundjeve të tjera dhe konsiderohet të jetë një prej bimëve shëruese më të mëdha të të gjitha kohërave.

Përbërësit: Fara e zezë përmban përafërsisht 38 % karbohidrate, 35 % vajra të ndryshëm, 21 % albumin dhe pjesa tjetër përbëhet prej më shumë se njëqind substanca të ndryshme. Për t'u përmendur janë: vajrat acidike të pangopura, acidi Linolein, acidi alfa-Linolein, vajrat me eter (nigellon, alfa-pinen etj.), vitaminat (B1, B2, B6, Acidi Folik, Niacina), mineralet (hekur, kalcium, magnez, zink, etj.) dhe aminoacidet. Acidi folik redukton rrezikun e tensionit dhe sëmundjeve të zemrës, gjithashtu është i nevojshëm në rinovimin e qelizave. Antioksidantët si vitaminat A, E, C dhe Beta-Karotin forcojnë sistemin mbrojtës të trupit. Farat përmbajnë shumta e strukturore të pazakontë acideve yndyrore të pangopuara. Përveç p-cymene (40%), α -pinene (deri në 15%), dithymoquinone dhe thymohydroquinone, në vajin esencial të farës së zezë është identifikuar si përbërës kryesor thymoquinone (deri në 50%). Gjithashtu janë gjetur sasi gjurmësh të derivateve të tjera terpene, si: Carvacrol, carvone, limonene, 4-terpineol, citronello. Për më tepër, vaji esencial përmban sasi të konsiderueshme acidi ethyl (10%). Fara e zezë përmban edhe një vaj yndyror të pasur me acide yndyrore të pangopura, kryesisht linoleic acid (50 - 60%), acid oleic (20%), acid eicodadienoic (3%) dhe acid dihomolinoleic (10%), që është karakteristike për gjinitë. Acidet yndyrore të ngopura (palmitic, acid stearic) gjenden rreth 30% ose më pak. Vaji i farës së zezë gjithashtu mund të përmbajnë pjesë të vajit esencial, kryesisht thymoquinone, nga të cilat ajo merr një shije aromatike.

Veçoritë e vajrave acidik të pangopura:

- Ndhimjnë metabolizmin e trupit
- Nevojiten në rritjen, zhvillimin dhe rinovimin e qelizave
- Ndhimjnë në zhvillimin e hormoneve dhe në formimin e një sistemi nervor dhe hormonal, mbrojtës të shëndetshëm.
- Pengojnë shtimin e substancave që dërgojnë sinjale alergjike
- Ndalojnë qelizat mbrojtëse (imunitare) të punojnë më shumë se ç' duhet.
- Kolesterolin në gjak e kthejnë në nivele normale
- Pengojnë bllokimin e damarëve duke rregulluar strukturën e tyre dhe njëkohësisht shpejtësinë e qarkullimit të gjakut
- Ulin tensionin dhe reduktojnë rrezikun e ashpërsimit të damarëve dhe infraktit në zemër
- Ndhimjnë në përmirësimin e shpejt të plagëve
- Trupi i njeriut nuk i prodhon këta vajra dhe është i detyruar t'i marrë nga jashtë, 1gr. Vaji i Farës së Zezë është i mjaftueshëm për nevojat ditore.



Veprimet e farës së zezë

- Analgjezik: lehtëson ose ul ndjesinë e dhimbjes.
- Anthelmintik: (e nohur ndryshe si krimbambytës ose vermifuge) shkatërron dhe largon krimbat e zorrëve.
- antibakterial: shkatërron ose e pengon rritjen e bakteve shkatërruese.
- anti-inflamator: zvogëlon ose reduktin inflamacionin.
- anti-mikrobial: shkatërron ose pengon zhvillimin e mikroorganizmave shkatërrues.
- Antioksidant: Ndalon ose vonon oksidimin e dëmshëm të qelizave të trupit- veçanërisht e dobishme kundër radikaleve të lira.
- Anti-pyretik: (i njohur ndryshe si anti-ethe) - shfaq një "veprim ftohës", të dobishme në reduktim të etheve.
- Anti-spazmatik: parandalon ose lehtëson spazmat e muskujve dhe ngërçet.
- Anti-tumoral: kundërvepron ose pengon formimin e tumoreve malinje
- Karminative: nxit tretjen dhe realizon largimin e gazrave të dëmshme nga stomaku dhe zorrët.
- diaphoretic: d.m.th nxit djersitjen gjatë temperaturës së lartë trupore duke e ulur atë dhe duke stimuluar çlirimin e toksinave.
- diuretike: stimulon urinimin dhe largon nga trupi ujërat e tepërta.
- Digestive: ndihmon në procesin e tretjes së ushqimit.
- Emmenagogue: Stimulon rrjedhjen dhe aktivitetin menstrual.
- Galactagogue: Stimulon rrjedhjen e qumështit tek nënat e reja.
- Hypotensive: zvogëlon presionin e lartë të gjakut.
- Immunomodulator: forcon aktivitetin e sistemit imunitar, e nevojshme kjo për një bilanc optimal.
- laksative: kundër kapsllëkut.



Vajrat me eter si Nigellon dhe alfa-Pinen zgjerojnë rrugët e frymëmarrjes, lehtësojnë kollitjen, pengojnë qelbëzimin dhe ndalojnë dhimbjen. Nëse përdoren rregullisht ulin sheqerin në gjak. Vitaminat B1, B2 dhe B6 luajnë rol në prodhimin e enzimave dhe forcojnë sistemin mbrojtës. Është mjaft efektiv ndaj sëmundjeve alergjike si astma dhe alergjia ndaj polenave. Për efektin që ka në sistemin imunitar është i këshillueshëm përdorimi në sëmundjet si AIDS-si, kanceri etj. Në një nga studimet për farën e zezë është bërë një testim me mbi 600 pacientë. Në këtë studim është zbuluar se rreth 70% e pacientëve në kushte alergjike, në mesin e tyre disa alergjikë nga poleni i luleve dhe nga pluhurat, azmatikë u shëruan nga Nigella Sativa. Kur dëgjojmë kaq shumë gjëra të mira dhe mrekulli në një bimë të vetme bindemi për mrekullitë që i ka krijuar Zoti xh.sh dhe e falenderojmë Atë për çdo të mirë që ka krijuar për ne, në qiell apo në tokë qoftë.



Të bukur e të shëndetshëm

Kujdesi dhe vëmendja për të pasur flokë të bukur e të shëndetshëm, ka shkuar krahas zhvillimit në përgjithësi të shoqërisë njerëzore. Thellimi i njohurive mbi përbërjen dhe funksionet e organeve të njeriut, nuk ka lënë në harresë gjithçka që lidhet me flokët, që nga ndërtimi i tyre, kërkesat për një rritje normale dhe faktorët që ndikojnë në rënien e tyre, e deri te kujdesi që duhet treguar për përdorimin e produkteve dhe pajisjeve të ndryshme për një paraqitje sa më estetike të tyre.

Flokët kalojnë një cikël normal të rritjes e rënies së tyre. Kështu, koha normale e rritjes së flokëve zgjat nga 2 deri në 6 vjet. Rreth 90% e fijeve të flokëve rriten gjatë kësaj faze 1 cm në muaj dhe vetëm 10% e tyre qëndrojnë në fazën e qetësisë. Pas 2-3 muaj fijet e flokut, që ishin në fazën e qetësisë, bien dhe fije të tjera floku rriten në vendin e tyre.

Katër vitaminat që nevojiten për flokë të shëndetshëm

Vitamina **A** gjendet kryesisht te: mangoja, portokalli, karota, patatja, etj. Por, duhet pasur kujdes, sepse përdorimi i shtuar i saj e përkeqëson më tej rënien e flokëve.

Vitamina **B** (i gjithë kompleksi i vitaminës B) rrit sasinë e hemoglobinës, duke çuar në një furnizim më të mirë me gjak të lëkurës së kokës. Vitamina B6 gjendet kryesisht në ushqimet e pasura me proteina, duke realizuar në këtë mënyrë njëherësh proteinat dhe vitaminën B6. Ushqimet e pasura me vitaminë B janë: patatet, fasulet, drithërat, mishi i lopës dhe i pulës.

Vitamina **E** rrit thithjen e oksigjenit në lëkurën e kokës. Ajo gjendet në vajrat e ndryshme, si ai i sojës, i bajames, i misrit, etj.

Vitamina **C** është përgjegjëse për rritjen normale të kolagjenit (pjesë ndërtuese e fijos së flokut). Ajo gjendet kryesisht në agrume, kivi, specat e kuq, etj. Katër minerale që nevojiten për flokë të shëndetshëm:

Minerali i silicit është më kryesori në rritjen normale të flokëve, por që shpesh mungon në dietat. Metodot e konservimit dhe përpunimit të ushqimeve bëjnë që ky mikroelement të shkatërrohet. Megjithatë, ju mund ta gjeni në ushqime, si: tërshëra, meli apo algat.

Jodi, shpesh në dietën e përditshme, merret përmes kripës së jodizuar, megjithatë nuk është ky lloj jodi që ndikon në flokë të shëndetshëm, por është jodi i marrë nëpërmjet

ushqimeve, si: leshterikët, kosi, qumështi i lopës, vezët e ziera, luleshtrydhet dhe djathi mozarrella.

Zinku, ndihmon në thithjen e elementëve të tjerë që duhen për rritjen e flokut, por ndalon dhe formimin e zbokthit i cili ndikon në rënien e flokëve. Gjendet kryesisht në mëlçi, në mishin e viçit, në fasule, bajame, xhenxhifill, etj.

Hekuri, mundohuni të merrni sasinë e nevojshmetë hekurit nëpërmjet ushqimeve dhe jo nëpërmjet medikamenteve, si sulfat hekuri, i cili është i vështirë për t'u përthithur nga organizmi. Ndër ushqimet e pasura me hekur përmendim: mishi i kuq pa dhjamë, mëlçia, mishi i shpendëve, peshku ton, drithërat, fasulet e thata, frutat e thata, perimet me gjethe jeshile, bathët, kumbullat e thata, kajsitë, spinaqi, brokoli, etj. Nëntë ushqimet që ndihmojnë në parandalimin e rënies së flokëve

1. Mishi i pulës është i pasur me zink dhe vitaminë B6.
2. Mishi i viçit - edhe ky është i pasur me vitaminë B6, zink dhe proteina.
3. Vaji i sojës – përmban kryesisht proteina, por edhe hekur dhe vitaminë E.
4. Bajamet – të pasura me proteina, hekur e vitaminë E.
5. Buka e zezë – përmban silic dhe hekur.
6. Qumështi i lopës – përmban jod natyral, që përthithet nga organizmi.
7. Tërshëra – e pasur me mikroelemente, si: hekur, kalium, fosfor dhe magnezium.
8. Portokajtë – përmbajnë sasi të madhe të vitaminës C.
9. Peshku – përmban vitaminë A, B6, proteina dhe acide yndyrore esenciale.

Disa këshilla të thjeshta, që duhen ndjekur në shtëpi për trajtimin e rënies së flokëve.

Fërkoni me vull lëkurën e kokës me mollëzat e gishtave pas larjes me ujë të ftohtë, derisa të fitojë nxehtësinë e duhur, duke ndihmuar punën e gjëndrave sebace dhe furnizimin më të mirë me gjak, që ndihmojnë në rritjen e tyre.

Sallata jeshile ndihmon në parandalimin e rënies së flokëve. Një përzierje e lëngut të sallatës jeshile dhe spinaqit apo e lëngut të karotës përmirëson rritjen e flokëve.

Përdorimi i përditshëm i përzierjes së vajit të arrës së kokosit me lëng limoni, parandalon rënien e flokëve dhe i forcon ato.

Aplikimi direkt në lëkurën e kokës dhe masazhimi i saj me qumështin e arrës së kokosit ngadalëson rënien e flokëve, duke i ushqyer ato. Qumështi i arrës së kokosit përfitohet duke i grirë dhe më pas shtrydhur arrat e kokosit.

Farat e limonit përzier me kokrrat e piperit të zi, të grira së bashku, derisa të formojnë një si pastë të imët, aplikohet në flokë, ndihmojnë në qarkullimin e gjakut.

Disa nga shkaqet që dëmtojnë flokët:

- **Krehja e tepërt** - krehja dhe furçimi i tepërt, sidomos kur flokët janë akoma të lagët, mund të shkaktojnë dëme serioze të flokëve. Krehja të bëhet me ngadalë dhe me krehër me dhëmbëza të gjëra apo furça të përbëra nga fibra natyrale.
- **Karficat dhe kapëset e ndryshme** – shkaktojnë tensionim të flokëve në vendin ku ato vendosen dhe çojnë edhe në këputje të flokëve.
- **Nxehtësia e tepërt** – këshilla më e mirë është që flokët të thahen në mënyrë natyrale e të mos përdorni mjete të tjera tharëse. Por nëse vërtet ju duhet të përdorni tharësen e flokëve apo pjastrat e ndryshme, gradojini në gradën më të ulët të mundshme.
- **Dielli** – jo vetëm lëkura kërkon mbrojtje nga rrezet ultraviole, por edhe flokët, madje edhe në stinën e dimrit. Prandaj mirë është që të përdorni kapele kur ekspozoheni në diell.
 - **Uji me kripë dhe uji i klorinuar** – pas notit, në një vend me ujë të kripur apo të klorinuar, gjithmonë lajini flokët tuaj me shampo pastruese. Kripa dhe klori në flokët tuaj i bën më të thatë e më të brishtë. Ekzistojnë disa shampo të posaçme që përdoren për notarët.
 - **Larja e tepërt** – shkakton tharje të flokëve dhe të lëkurës së kokës dhe pakëson vajrat natyralë, që mbrojnë rrënjët e flokëve.
 - **Moti i ftohtë** – shkakton tharje më të shpejtë të flokëve, sepse lagështia në ajër është më e vogël, duke i bërë flokët jo vetëm më të thatë, por edhe më të brishtë e të thyeshëm.
 - **Permanenti i tepërt** – Shkoni sa më pak të jetë e mundshme në parukeri. Çdo mjet që përdoret në parukeri e që lëshon nxehtësi i bën flokët më të thatë e më të brishtë, duke i dëmtuar ato. Flokët kaçurrel kanë një strukturë kimike të veçantë. Atomet e squfurit në përmbajtje të proteinave të flokëve lidhen së bashku nëpërmjet lidhjeve disulfore e në flokë krijohen format kaçurrela. Nxehtësia bën të mundur këputjen e këtyre lidhjeve, duke ndikuar në strukturën natyrale të flokut. Gjithashtu, kujdes duhet t'i kushtohet dhe bojërave dhe lyerjes së flokëve, sepse kimikatet në përbërje të bojërave shkaktojnë dëmtime të flokëve dhe kjo sidomos kur flokët lyhen shpesh.

RAMAZANI

suplement

2010^{-TA}

*Kur të gjithë mbyten anktheve
e sfidave të dështuara,
ti forco besimin duke agjëruar!*



*Për një
Ramazan si
kurrë më parë...*

KRYEREDAKTORJA

Është verë! Shumë prej njerëzve e pëlqejnë këtë stinë duke e dalluar nga të tjerat, me plot avantazhet që ajo ka. Është mirë kur bën vapë dhe nuk të duhet të vishesh trashë e as të fërkosh duart e të ngrohesh me frymën tënde. Por është më mirë kur në një stinë përjeton në vetvete dy stinë, dy realitet po njerëzore që sikur të ishim më të vëmndshëm ndaj tyre, do të ishim njerëz më të mirë, besimtarë më të devotshëm.

Kështu vera vjen me shumë diell, me pak ujë, me shumë mëkate, pakujdesi e pak vigjilencë e durim, me shumë dëshira e me pak punë për ta.

Pa ç'ka se dielli kuqëlon mbi kokat tona, ne sërish e numërojmë veten tek "të shpëtuarit", ndërkohë që duhet të jemi prej atyre që dielli të na përkujojë mirësinë e madhe pa të cilin s'do merrte frymë e gjithë bota, por duhet të na sjellë ndër mënd edhe zjarrin e fortë, atë që nuk shuhet kurrë, i cili është ndezur për të padrejtët e mëdhenj, gabimtarët e papenduar e mosbesimtarët që kënaqen me mëkatet e tyre.

Jo më pas ngelen besimtarët e dhënë pas kësaj bote që ikën pa e ndier, besimtar i cili harron, gabon sërish e sërish.

Por, si për mirësi të Atij që mëshiron shumë, të nxehtët këtë vit vjen me një muaj që shuan zjarrin që dënon, muaj ku mëshirohen mëkatarët që dinë të pëndohen, është ai muaji, që e presim me aq dashuri, Ramazan 2010.

Tek ky muaj, e shikojmë veten se ku ishim dhe ku duhet të arijmë,

si para një pasqyre që nuk tregon aq sa je, ndodhemi para një Ramazani që po vjen e pas një Ramazani që lamë pas.

Jemi akoma të dobët! Ku janë kërkesat, qëllimet tona për këtë Ramazan, detyrat që ia kemi vënë vetes, arritjet e mos arritjet në Ramazanin tjetër a do t'i sendërtojmë e materializojmë në këtë Ramazan i cili vjen si një mundësi e dytë për pastrim e shpëtim?!

Duhet kujtuar historia e profetëve të dashur, e shokëve të tyre që 6 muaj para Ramazanit prisnin Ramazan, e 6 muaj pas tij jetonin duke përkujtuar mirësitë që panë në të.

Duhet kujtuar dijetarët, të cilët duke e ditur se rëndësia e Agjërimit mbështetet fort edhe mbi pozitën e Kuranit, leximit të tij tek besimtari sidomos gjatë këtij muaji, ata linin mënjane marrjen e dijes e çdo gjë shpërqëndruese e parësor për ta ishte leximi i këtij libri, i cili u zbrit po këtë muaj, në një Natë të Madhe.

Ky është viti i begatë i besimtarëve, i të parëve të mirë, i asaj pale të shpëtuar.

Është vapë dhe vështirë-shprehen disa lidhur me agjërimitin e sivjetshëm.

I dëgjojmë fjalët që më shumë e vështirësojnë një agjërimitin mes rrezesh që vërsulen dhunshëm sidomos mbi krerë të pabindur, ndaj dhe lusim Zotin le të jetë ky Ramazan lehtësim e freski në këtë botë e në botën tjetër.

Ajo çfarë duhet të na kujtojë kjo vapë është stërvitja e durimit, përkujtimi i një vape akoma më të madhe zjarrit të dënimit, e në

këtë mënyrë, të dyja këto kahe të na çojnë drejt përsosjes së sakrificës tonë për të qënë prej atyre që ju pranohet agjërimiti tek Zoti i tyre.

Kur sërish u pyet një njeri i njohur i ditëve tona dhe nuk ishte praktikant i një feje apo besimi se si e mendonte agjërimitin e muslimanëve këtë vit mes të nxehtit të madh, me tone sërish ironizuese, ai person u shpreh: "Respekt për ata që" sakrifikojnë".

Pra bota ku jetojmë sikur ironizon me afatet e kohët e adhurimeve që Zoti i cakton vetëm në të mirën tonë, pa ditur se fjala e tyre është kundër vetes së tyre, dhe bëhet shkak fjala e dikujt që madje nuk është praktikant i islamit ta thotë të vërtetën e saktë.

Vërtet shoqëria ku jemi ka nevojë për njerëz që dinë të sakrifikojnë, të lënë mënjane botën mes shijesh e babëzive e të vrapojë për tek ajo botë ku lihet mënjane materialja për të shpëtuar shpirtëroren, ku lihet mënjane egoja për të shpëtuar 'tjetrin', lihet një vënd bosh në stomaqet që s'ngopen kurrë, për të ushqyer atë që nuk u ushqye, për të ndihmuar, përkrahur e përjetuar së bashku me të varfërin realitetin e varferisë, atë të jetimit, atë të vobektit se në realitet ashtu është vetë vetja jonë: e varfër pa Zotin Tonë.

Ai është që na bën realë, na furnizon dhe e Atij është e gjithë madhështia.

Ai na bën vit pas viti agjërues, përrulës. A nuk është kjo mundësi e madhe për të shpëtuar?!

RAMAZANI

Falendërimet i takojnë vetëm Zotit, Sunduesit, Krijuesit, Mëshiruesit, Zotëruesit e gjithçkaje që janë në qiell e tokë dhe gjithçka që ndodhet ndërmjet tyre.

Paqja dhe begatia qoftë për Profetin, të Dërguarin e të gjithë njerëzimit, për familjen e tij, shokët e tij dhe për të gjithë ata që do të ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

U erdhi muaji i Ramazanit, muaji i begatisë, me të Zoti ju kaplon, ju zbret mëshirë, i mbulon gabimet, i përgjigjet lutjes, ...’ me këto fjalë Muhamedi (a.s) i nxiste besimtarët në lutje dhe adhurim, i ftonte ata e u thoshte: ‘... përgatituni për muajin e Ramazanit, edukohuni me edukatën e tij dhe fitoni dobi prej urtësisë dhe fshehtësive të tij’.

E pra, një prej të mirave që Zoti i Madhëruar na ka favorizuar, është edhe Ramazani.

Ramazani është muaji kur ndahen e drejta dhe e shtrëmbëra, e mira nga e keqja. Ky muaj përfshin të gjitha rrethinat që janë përreth në shpirtin e të drejtës, të virtytit dhe të dhëmbshurisë.

Sikurse bimët kanë sezonin e tyre të lulëzimit ashtu edhe Ramazani është koha e vitit për rritjen dhe lulëzimin e mirësisë dhe drejtësisë. Në këtë muaj, të gjitha mëkatet anulohen, sepse Zoti i Madhëruar gjatë këtij muaji i dhuron amnistinë e përgjithshme të gjithë besimtarëve pa dallim.

Agjërimi në Ramazan është shkruajtur si recetë nga vetë Zoti, si formë adhurimi e lutjeje dhe gjithashtu si një periudhë stërvitjeje, që të zhvillohet më shumë devotshmëria

dhe bujaria, si dhe për të treguar mirënjohjen dhe favorët e mëdha të zbulimeve të Kur’anit gjatë muajit të Ramazanit, të Natës së Kadrit si edhe në përmbushjen e

Urdhërave të Sunduesit.

Ramazani është pranuar si një muaj i rëndësishëm në shoqërinë islame për zbatimin e drejtësisë shpirtërore, në këtë muaj nuk ka ndryshim midis stomakut të të varfërit e atij të pasurit.

Ramazani është “varfëri” e obliguar sepse të gjithë njerëzit janë të barabartë e ndejnë vuajtje të njëjta. Nga vuajtjet lind mëshira kurse nga mëshira drejtësia. Sa e bukur do të ishte jeta sikur të gjithë të kishin vuajtje dhe ndjenja të njëjta. Sa e bukur do të ishte koha edhe sikur të ishte krejt Ramazan, sepse ai realizon gjërat më të rëndësishme në shoqëri; barazinë dhe rehatinë.

Ramazani është muaji kur pastrohemi prej një viti papastërtish, sëmundjesh trupore dhe shpirtërore. Gjatë këtij muaji ne luftojmë me dëshirat tona të natyrshme e legale si të ngrënët e të pirët në mënyrë që të mund të fitojmë vullnetin për të braktisur mëkatet dhe dëshirat tona të ndaluara. E nëpërmjet agjërimit hiqet dorë prej gjërave të ndaluara si gënjeshtra, shpifja dhe thashethemet...

Ramazani na dhuron “të vërtetën”, “fuqinë” dhe “lirinë” gjatë ditëve të urisë dhe të etjes, sepse gjatë lutjeve dhe aplikimit të urdhërave të Zotit, agjëruesi ndien liri të plotë dhe pavarësi nga çdo tjetër, përveç Atij.

Agjërimi është disiplina më e drejtë e të gjithë disiplinave shpirtërore që i imponohen çdo të rrituri musliman, grua apo burrë qoftë. Qëllimi i tij është t’a ndihmojë zhvillimin e vetfrenimit dhe vetpastrimit, ndërsa qëllimi i të ushqyerit shpirtëror është aftësimi i njeriut për të arritur afërsinë me Zotin e për të përfituar kënaqësinë e Tij. Agjërimi është lartësim i shpirtit, mbrojtës i njeriut, ai edukon, formon, rilind, disiplinon,



fisnikëron dhe zhvillon ndjenjën dhe shijon për të bukurën, atë që është humane dhe e dobishme. Në trupin e uritur zemra bëhet e pastër, ndërsa ngopja, verbon zemrën dhe turbullon mendjen. Agjërimi është akti më intim i devotshmërisë, a nuk thotë Zoti i Lartësuar : “ O ju që besoni. Agjërimi është bërë obligim për ju ashtu siç iu është bërë obligim edhe atyre që ishin para jush. Që ju të jeni më të devotshëm.” (2/183).

Agjërimi ashtu sikur obligimet e tjera islame, duhet të jetë përpjekje e fisnikërimit të vetes me moralin hyjnor.

Ramazani është muaji i bekuar, i mëshirës, dhe rikushtimit, muaji i bashkimit me të varfërit dhe të uriturit, muaji unik i vetëanalizës, i rishikimit të vlerave morale e shpirtërore. Devotshmëria është me të vërtetë fryti më i vlefshëm i agjërit. Agjërimi është një detyrë, një ibadet, e gjatë kësaj kohe njeriu nënshton kafshërinë brenda vetes dhe zotëron instiktet dhe dëshirat e tij.

Ky muaj quhet edhe muaji më i shpejtë për të gjithë muslimanët. Në këtë periudhë besimtarët përpiqen që t'ia dedikojnë sa më shumë kohën Zotit, e prandaj ky muaj është koha e të vjelave të frutave të veprimeve tona. I dërguari i Zotit ka thënë : ‘ Çdo veprim i mirë i një njeriu, i dhurohet rritja e shumëfishtë nga 10 – 700 herë’. Por Zoti i Madhëruar thotë : “ Agjërimi është një përjashtim sepse ai është për Mua dhe Unë do t'a shpërblej aq sa Unë do të dëshiroj. Dhe Zoti gjithmonë i paguan llogaritë plotësisht.” (35/30).

Gjatë këtij muaji ne festojmë përvjetorin më të rëndësishëm të njerëzimit, zbulimin e Kur'anit të shenjtë në Natën e Kadrit, që është nata e fuqisë dhe e lavdisë, e për këtë Profeti (a.s) në një hutbe të tijën të mbajtur gjatë muajit të Ramazanit ka thënë : ‘O njerëz! Një muaj i madh e

i bekuar ju ka marrë nën hijen e tij. Një muaj i tillë brenda të cilit ndodhet një natë që është më e dobishme se një mijë muaj, Nata e Kadrit. Një muaj gjatë të cilit Zoti ka bërë detyrim agjërimin ditën e teravitë natën. Ai që bën një të mirë gjatë këtij muaji, fiton të mirë sikur të kishte kryer një farz(detyrim) në kohët e tjera. Dhe ai që zbaton një farz këtë muaj, është sikur të ketë kryer 70 farze gjatë muajve të tjerë.’


Ramazani është muaji i durimit, kurse shpërblimi i durimit është Xhen'neti. Ramazani është muaji i barazisë e i shtimit të mirësisë. Fillimi i tij është mëshirë, mesi është falje dhe fundi është shpëtim prej zjarrit të Xhehen'nemit. Ai që gjatë Ramazanit i jep lirinë skllavit të tij, edhe Zoti e fal atë dhe e shpëton nga zjarri.’

Të mirat me të cilat na ka favorizuar Zoti i Madhëruar janë të panumërta e të pafundme. Çdo ditë, çdo minut dhe çdo çast ne notojmë në këto të mira. A nuk është Zoti, Ai që e përgatit kokrrën e farës që mbjellim, që na ngop me bukë, që na shuan etjen duke zbritur ujë të ëmbël nga qielli dhe që na mundëson të marrim frymë gjersa të ngopemi nga ajri i pastër? Të njejtat mirësi vazhdojnë të jenë edhe në Ramazan.

Ramazani erdhi

Ata që e trajtojnë si muaji i urisë së ditës, ngopjes së natës dhe leximit formal të Kur'anit nuk do të kenë kurrfarë dobie prej tij. Endërsa ata që e konsiderojnë si shkollë për përtëritjen e besimit dhe edukatës, për forcimin e shpirtit dhe vazhdimin e një jete më të mirë e më të përkryer, do të kenë dobi prej tij, do të fitojnë kënaqësinë dhe shpërblimin. Të përgatitemi pra për këtë muaj të madh, të edukohemi me edukatën e tij dhe të fitojmë dobi prej urtësisë së tij.

Dyert e parajsës, të mëshirës, të faljes, të shpëtimit, janë hapur, ejani të hyjmë në to...I.M





Ramazani për gruan është një festë e shpirtit

Profeti a.s
thotë:
**“O ju gra!
Jepni sadaka
dhe kërkoni
më shumë
falje Allahut,
sepse unë
pashë që
ju përbëni
pjesën më
të madhe të
banorëve të
xhehenemit!”**

Muaji i Ramazanit është muaji i shenjtë në të cilin u zbrit Kurani. Ky është muaji i agjërimit vetëm për hir të Krijuesit.

Po na vjen një mysafir i rrallë dhe shumë i rëndësishëm për të cilin duhet të përgatitemi. Duhet që në këtë muaj vetëdija jonë të ngrihet dhe këtë mysafir ta presim me seriozitet dhe me ambicie të larta në mënyrë që të përfitojmë sa më shumë prej tij.

Muaji i Ramazanit është muaji i obligueshëm për t’u agjëruar si për burrat dhe për gratë, por për gruan ai vjen më i ngarkuar, sepse gruaja është ajo që krahas adhurimit në këtë muaj është e detyruar të gatujë për familjen e saj. Fatkeqësisht në realitet shohim gratë që stërmundohen dhe kalojnë në muajin e Ramazanit orë të tëra në kuzhinë, por absolutisht ky muaj nuk është muaji i ushqimit, përkundrazi. Ramazani është muaji i adhurimit të Zotit, njësoj si për burrat ashtu dhe për gratë.

Gruaja në prag të ardhjes së Ramazanit ka në mendjen e saj

gatimet që do të bëjë në këtë muaj, përkujdesjen për shtëpinë, bërjen e pazarit e të tjera si këto. Të tilla gjëra janë të domosdoshme deri në një kufinj të caktuar, por kur tejkalohen të shpërqëndrojnë vëmendjen dhe të marrin kohën.

Muaji i Ramazanit është muaj feste, por jo vetëm për të ndritur e shkëlqyer shtëpinë dhe rritur shpenzimet apo për ta pasuruar tavolinën me gatime të shumëllojshme. Ky muaj vjen për të nderuar edhe urinë dhe falenderimin e një ushqimi të thjeshtë. Është muaj feste, por muaj feste për shpirtin, për pastrimin e tij nga të kqëqijat, nga gjynahet si smira, zilia, koprracia, mendjemadhësia, duke na kujtuar që është e mundshme të jetohet edhe me pak ushqim, me pak ujë, me pak gjumë dhe duke na e larguar nga gjaku teprinë. Është e rëndësishme që muajin e Ramazanit ta bëjmë në hapat e të parëve tanë të mirë! Ata e përgatisnin mendjen dhe shpirtin gjatë muajve para ardhjes së tij, prandaj i gjente të gatshëm për ta plotësuar devotshmërinë.



“O ju që besuat, ju është bërë obligim agjërimi sikurse atyre para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” [Bekare, 83] Shtëpitë, pajisjet, ushqimet e të parëve tanë të mirë kanë qenë të thjeshta, jo ngaqë s’kishin apo s’mundeshin, porse e kishin dëbuar dynjanë nga shpirti i tyre dhe trupi nuk ua kërkonte. Andaj mund të falnin gjatë namaz, të lexonin sa më shumë Kuran, të përmendnin sa më shpesh Zotin dhe të thelloheshin në dijet fetare. Disiplina e vazhdueshme mundëson lehtësim dhe përfitim të kohës për kryerjen e gjithçkaje. Gjatë këtij muaji gratë janë nën trysinë se çfarë do të gatuajnë për iftar. Është mirë që gruaja të ecë me një plan ditor, të mirëmenaxhojë kohën, në mënyrë që e gjithë dita të mos t’i kalojë në kuzhinë. Edhe nëse do të bëjë një iftar me gatime speciale apo të organizojë një iftar për të afërmit apo për miqtë, është më mirë që gruaja ta lejë në fundjavë ku ka më shumë kohë të lirë. Ramazani është muaji ku duhet të mendojmë për Zotin dhe për të varfërit dhe jo për të gatuar hallva, bakllava apo lloj lloj gatimesh të veçanta.

Besimtarja në këtë muaj duhet të angazhohet në adhurime, si në xhami ashtu edhe në shtëpinë e saj në rast se ajo nuk ka mundësi të marrë pjesë në xhami.

Gruaja muslimane duhet që në Ramazan të lexojë sa më shumë Kuran. Të lexojë për jetën e të dërguarit Muhamed dhe të nxjerrë dobi dhe mësim nga jeta e tij a.s. Të përmendë Zotin sa më shpesh gjatë ditës, sepse nuk ka aktivitete më të mirë për njeriun sesa përkujtimi dhe madhërimi i Zotit xh.sh. Gatimi për familjarët ose për të varfërit me nijetin vetëm për hir të Zotit. Falja e teravive në xhami ose në shtëpi, në varësi të mundësive të saj. Edhe itikafi është një tërheqje shpirtërore. Ky është një adhurim të cilin e bëjnë burrat, por mund ta bëjnë edhe gratë në rast se në xhamitë e tyre janë mundësitë dhe kushtet për një gjë të tillë.

Në fund të ditës, ajo që muslimania e mirë dëshiron për muslimanen tjetër është afrimi me Zotin. Nëse nuk keni arritur atë që keni dashur nga ky ramazan, atëherë bëjani të ditur burrit, familjes ose shoqërisë suaj në mënyrë që t’ju ndihmojnë të arrini atë ngritje shpirtërore që të gjithë e dëshirojnë. Ndhmoni motrat e tjera muslimane që gjenden në të njëjtën situatë dhe zotohuni të ndihmoni njëra-tjetrën të qëndroni të kapura fort pas fesë së Zotit.

Në këtë muaj të begatë të keqes afroju me të mirë dhe me të mirën këshillo! Fal, të falesh! Mëshiro, të të mëshirojë Zotidhejepsadakatashuashflakënezjarrit! Profeti thotë: “O ju gra! Jepni sadaka dhe kërkoni më shumë falje Zotit, sepse unë pashë që ju përbëni pjesën më të madhe të banorëve të xhehenemit!” “Jepni sadaka, o gra, qoftë edhe prej stolive tuaja!” Sadakaja është dëshmi për ty, e vendosur në thesarin e ahiretit, pa e parë as duart e tua, është vërtetim, bindje e thellë se ke bërë me të tregtinë më të drejtë.

Nga sa lexuat si mendoni cili është roli i gruas në muajin e Ramazanit? Mos vallë i gjithë munda i saj duhet të jetë në artin e gatimit? Çfarë ka punuar ajo për Krijuesin e saj në këtë muaj? Mos të jetë angazhimi yt kryesor arti i gatimit, por të jetë: dhikri, leximi i Kuranit, namazi i natës e ibadetet e tjera. Shfrytëzoheni këtë muaj para se të shkojë pa e kuptuar, sepse nëse do të tregoheni të pakujdesshëm, të jeni të sigurt se në fundin e tij keni për t’u penduar!



Agjërimet

Por megjithatë, të gjitha këto lloj agjërimesh vullnetare edhe mund të ndërpriten. Dhe si argument kemi një transmetim nga Umu Hani që tregon se profeti hyri në dhomën e saj ditën kur u çlirua Mekah. I dhanë atij për të pirë dhe piu. Pastaj ai ia dha Umu Hanit por ajo i tha se agjëronte. Profeti (a.s) i tha : “ Ai që agjëron vullnetarisht është përgjegjës për veten e tij, nëse do, agjëro e nëse do prishe agjërimin tend” (Ahmedi, Darakutni).... Nga kuptojmë se nëpër të gjitha ditët e vitit ka vend për agjërim vullnetar, me këtë kuptojmë se është i lejuar agjërimi edhe pas Ramazanit, e për këtë kemi fjalën e profetit, i cili na nxit për të agjëruar në ditët e mëposhteme...

Agjërimin e ndajmë në dy lloje : në agjërim të detyruar dhe agjërim vullnetar.

Në agjërimet e detyruara hyjnë :

- agjërimi i muajit të Ramazanit
- agjërimi për shkeljen e normave fetare apo për pamundësinë e kryerjes së tyre
- agjërimi që bëhet i obligueshëm për shkak të ndonjë betimi të bërë.

Ndërsa në agjërimet vullnetare hyjnë :

- agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit
- agjërimi i dhjetë ditëshit të parë të Dhul'hixhes,
- agjërimi i Ditës së Arafatit
- agjërimi i muajit Muharrem
- agjërimi i ditës së Ashuras
- agjërimi i ditës Tasua (dita e nëntë e muajit Muharrem)
- agjërimi i pjesës më të madhe të muajit Sha'aban
- agjërimi i ditëve të bardha
- agjërimi i tre ditëve të çdo muaji
- agjërimi i ditës së hënë dhe të enjte
- agjërimi një ditë po e një ditë jo
- agjërimi gjatë “muajt e ndaluar”

Agjërimi i gjashtë ditëve nga muaji Sheual.

Është transmetuar nga Ejub El' Ensari se profeti (a.s) ka thenë “ Kush agjëron Ramazanin dhe e përcjell atë me **gjashtë ditë të muajit Sheval**, është sikur të ketë agjëruar një vit të plotë, kush bën një të mire shpërblehet me 10 të tilla”.

Sipas hanefisë agjërimi i këtyre ditëve është e pëlqyeshme që të agjërohet nga dy ditë për çdo javë.

Por sipas Ahmedit këto ditë mund të agjërohen rrjesht ose jo, pasi asnjëra nuk preferohet nga tjetra.

Agjërimi i dhjetë ditëshit të parë të Dhulhixhes dhe veçanërisht Dita e Arafatit që i takon nëntë Dhulhixheh, për ata që nuk janë në haxh.

Hafsa tregon se profeti (a.s) pesë gjëra nuk i kishte braktisur kurrë; agjërimin e ditës së Ashures, **agjërimin e dhjetë ditëshit**

vullnetare

të parë të Dhulhixhes, agjërimin e tre ditëve të çdo muaji dhe faljen e dy rekateve para namazit të agimit. (Musned Ahmed 6/287 dhe sunen Nisai 4/189). Agjërimi i këtyre ditëve është quajtur i pëlqyeshëm nga profeti (a.s) sepse ato janë ditë të begata dhe në to dyfishohen veprat e mira dhe begatitë.

Ndërsa përsa i përket ditës së **nëntë të Dhulhixhes** që i takon **Ditës së Arafatit**, kjo ditë është quajtur e tillë, për qëndrimin mbi Arafat, gjithashtu thuhet se profeti Ibrahim (a.s) kur pa në ëndërr se ai u urdhërua që të bëjë kurban të birin fillojë të mendojë me maturi, se kjo është thjesht një ëndërr apo është një urdhër i Zotit, e kur natën e dytë ju përsërit e njehta gjë, dita që e pasoi u quajt dita e njohjes (arafatit) sepse ai e kuptoi se ajo ëndërr ishte nga Zoti. Është transmetuar nga Ibn Kutade se profeti (a.s) ka thenë: "Agjërimin e Ditës së Arafatit ja dedikoj (kushtoj) Zotit sepse Ai të fal gabimet e vitit që kalon dhe të atij që pason) (Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe).

Por agjërimi i kësaj dite nuk është i pëlqyeshëm për ata që janë në Arafat, pra qëllimi është për haxhinjtë. Ebu Hurejra transmeton se profeti (a.s) ka thenë se e ka ndaluar i Dërguari i Zotit (a.s) agjërimin e Ditës së Arafatit, për ata që qëndrojnë në Arafat" ku ka për qëllim haxhinjtë. Ndërsa Umul ' Fadl ka thenë se njerëzit dyshonin nëse profeti (a.s) po agjëronte

në këtë ditë, ajo i dërgoi atij pak qumësht dhe ai e piu ndërsa po i orientonte njerëzit për në Arafat. (Buhari, Muslim).

Mos agjërimi i Ditës së arafatit për haxhinjtë bëhet për të treguar se kjo është dita e lutjeve dhe është ditë feste për ata që qëndrojnë mbi Arafat.

Ndërsa Imam Hanife thotë :“ ... lejohet edhe për haxhinjtë agjërimi në këtë ditë, por me kusht që të jetë i shëndetshëm, nëse ai është i dobët dhe i pafuqishën apo edhe i pamundur agjërimi i tij është i papëlqyer.

Agjërimi i muajit Muharrem, dita e Ashures....

Agjërimi i muajit Muharrem është quajtur agjërim mjaft i vlefshëm dhe këtë e tregon Ebu Hurejre në transmetimin e tij se profeti (a.s) ka thenë: " Agjërimi më i vlefshëm pas Ramazanit është në muajin e Zotit, Muharremin..." (Muslim)

Dita e Ashuras përkon me ditën e dhjetë të muajit Muharrem. Agjërimi i kësaj ditë është i pëlqyer, këtë e tregon edhe hadithi i transmetuar nga Hafsa (nëna e besimtarëve) se profeti (a.s) pesë gjëra nuk i kishte braktisur kurrë; **agjërimin e ditës së Ashures**, agjërimin e dhjetë ditëshit të parë të Dhulhixhes, agjërimin e tre ditëve të çdo muaji dhe faljen e dy rekateve para namazit të agimit.

Sekreti mbi agjërimin e kësaj ditë përkon me kohën kur Zoti i



Lartësuar e ndihmoi Musain (a.s) të shpëtonte prej faraonit dhe popullit të tij. Musai (a.s) e falenderoi Zotin duke e agjëruar këtë ditë. Më pas, kjo ditë është agjëruar edhe nga profeti Muhamed. E kjo gjë, është një shembull i qartë mbi unitetin e feve hyjnore.

Aishja tregon se kurejshët e kishin zakon të agjëronin ditën e Ashures përpara islamit. Por edhe profeti (a.s) e agjëronte atë ditë. Kur shkoi në Medine, ai vazhdoi të agjëronte dhe i urdhëroi njerëzit të agjëronin edhe ata, pastaj kur muaji i Ramazanit u bë i detyrueshëm, ai i tha; “ Kush dëshiron mund t’a agjërojë ditën e Ashuras dhe kush do mund ta lërë atë.” (Buhari 3/57 , Muslim).

Ndërsa Kutade transmeton se as’habët e kanë pyetur profetin (a.s) për agjërimin e ditës së Ashuras dhe ai i ka thënë: “Agjërimi i ditës së ashures i shlyen mëkatet e vitit të kaluar” (Muslim)

Sipas Buharit dhe Muslimit, Ebu Musa El’ Ashariu tregon se çifutët e nderonin ditën e Ashures si një festë Bajrami. Profeti (a.s) u tha atyre : “ Ju duhet të agjëroni në të.”

Agjërimi i ditës Tasua (dita e nëntë e Muharremit).

Ibn Abasi transmeton se i dërguari i Zotit (a.s) agjëroi ditën e Ashuras dhe i urdhëroi njerëzit që të agjëronin bashkë me të. Njerëzit i thane: O i Dërguari i Zotit ! kjo është dita që e nderojnë çifutët dhe të krishterët. Profeti (a.s) i tha : “ Nëse mbetem gjallë deri vitin e ardhshëm, me siguri do t’a agjëroj **ditën e nëntë të muajit Muharrem**” (Muslim)

Agjërimi i pjesës më të madhe të muajit Sha’aban (muaji që i paraprën Ramazanit...

Profeti agjëronte pjesën më të madhe të **muajit Sha’aban**. Aishja (r.a) tregon se kurrë nuk e kishte pare profetin (a.s) të agjëronte një muaj të plotë përveç Ramazanit dhe se kurrë nuk e kishte parë atë të agjëronte më shumë gjatë një muaji se sa në muajin Sha’aban. (Buhariu3/50, Muslim).

Një herë Usame Bin Zejdi i tha profetit : “ O i Dërguari i Zotit! Nuk të shoh të agjërosh në asjë muaj tjetër, ashtu siç bën në muajin Sha’aban. Profeti iu drejtua e i tha: “ Ai është muaji që njerëzit e neglizhojnë. Ai është midis Rexhebit dhe Ramazanit. Ai është muaji, gjatë të cilit ngrihen veprat tek Zoti i botërave dhe unë preferoj të jem agjërueshëm kur të ngrihen veprat e mira” (Ebu Dauti, Nisai) Transmetohet nga Enes që thotë: U pyet profeti se.cili agjërim është më i vlefshëm pas Ramazanit? Ai i tha: “ Muaji i Sha’abanit, për të madhëruar muajin e Ramazanit” (Tirmidhij 1/104).

Agjërimi i ditëve të bardha...

Këto ditë janë e 13 – ta, 14 – ta dhe e 15 –ta për çdo muaj hënor, u quajten ditë të bardha sepse hëna arrin plotësin e saj të plotë dhe drita e saj bëhet e fortë e ndriçon aq shumë sa duket sikur të jetë ditë. Transmetohet nga Melham El’ Kajs se ka qenë profeti (a.s) që na urdhëroi për të agjëruar ditët e bardha; **të 13-tën,14-tën e 15-tën** e këto ditë marin formën sikur të keni agjëruar të gjithë vitin.(Nisai).

Agjërimi i tre ditëve të çdo muaji...

Këto tre ditë nuk janë po të njëjtat me ditët e bardha që përmendëm më lart. (Fet’hul Barij 4/227) Nga Ibn Amër ka thënë se profeti (a.s) i ka thënë : **Agjëro 3 ditë për**

çdo muaj , sepse për çdo të mire shpërblehesh me dhjetë të tilla dhe kjo përkon me agjërimin e një viti të plotë” (Buhariu 3/51). E ndërsa Ebu Hurejra ka thenë ; më ka këshilluar i Dërguari i Zotit për tre gjëra; të agjëroj tre ditë të çdo muaji, dy rekate të namazit të Duhasë dhe tëp fal namazin e vitrit para se të fle” (Buhariu 3/53).

Agjërimi i ditës së Hënë e të Enjte...

Ebu Hurejra transmeton se ditët që Profeti (a.s) agjëronte më tepër ishin **e hëna dhe e enjtja**. Kur u pyet rreth kësaj ai i tha: “ Veprat paraqiten tek Zoti çdo të hënë dhe të enjte. Zoti fal çdo musliman apo çdo besimtar, përveç atyre që janë grinder me njëri – tjetrin. Ai thotë : Lërimi ata” (Ahmedi). Në një tjetër transmetim nga Ebu Kutade ka thenë; kur u pyet profeti (a.s) për agjërimin e ditës së hënë ai tha : “ Ajo është dita në të cilën unë kam lindur dhe është dita që më ka ardhur shpallja” (Muslim 8/51).

Agjërimi një ditë po e një ditë jo...

Ebu Selemëbin Abdurrahman transmeton nga Abdullah bin Amr se profeti (a.s) i ka thenë atij; “ Më kanë thenë se ti falesh natën dhe agjëron ditën”. Ai i është përgjigjur; Po o i Dërguari i Zotit. Pastaj profeti (a.s) i ka thenë : Agjëro dhe ha, falu dhe fli, pasi trupi yt, gruaja jote dhe mysafirët e tu kanë të drejta mbi ty. Është e mjaftueshme për ty që të agjërosh tre ditë të një muaji. Abdullahu donta ta nënshtonte veten e tij e i tha: O i dërguari i Zotit ! unë ka fuqi për më tepër. Profeti (a.s) i tha: “ Agjëro tre ditë në javë”. Ai i tha: Unë kam fuqi më tepër. Atëherë profeti i tha : “ Agjëro sipas agjërimin të profetit të Zotit, Dautit dhe mos bëj më

tepër.” Abdullahu itha; Cili ishte agjërimi i Dautit? Profeti (a.s) i tha: “ **Ai agjëronte një ditë dhe hante në tjetrën**”

Po në një transmetim tjetër profeti i ka thënë Abdullah bin Omar bin Asse agjërimi më i mirë është agjërimi i vëllait tim Dautit(a.s) (Buhariu 3/52).

Agjërimi gjatë ‘muajve të shenjtë...

Quhen dhe ‘muaj të ndaluar’ sepse(gjatë kësaj periudhe është e ndaluar vrasja) dhe këto muaj janë Dhulka’ade, Dhul’Hixhe, Muharrem dhe Rexheb. Është e pëlqyer gjatë këtyre muajve të agjërohet sa më shumë. një burrë nga Bahila shkoi tek profeti (as.) dje i tha : O i Dërguari i Zotit! Unë jam ai që erdhi tek ju një vit më parë . profeti i tha ; “ Çfarë të ka gjetur ke qenë shumë më i pashëm? Ai iu përgjigj; nuk kam ngrënë përveçse natën kur u largova prej jush. Profeti (a.s) iu drejtua dhe i tha: “ Përse e ke dënuar veten? Agjëro gjatë muajit të durimit (Ramazanit) dhe nga një ditë në çdo muaj”. Burri i tha; Më shto diçka tjetër, pasi unë kam më shumë forcë dhe mundësi për të agjëruar. Profeti (a.s) i tha: “ Agjëro nga dy ditë të çdo muaji.” Burri këmbënguli; Më shto përsëri. Atëherë profeti (a.s) i tha tre herë: “ **Agjëro nga ‘muajt e shenjtë’** dhe lëre agjërimin”. Ai më tregoi me tre gishtat e tij duke i mbledhur dhe i lëshuar ato.(E bu Dauti, Ibn Maxhe...) përse i përket faktit se profeti (a.s) i mblodhi dhe i lëshoi tre gishtat e tij, ai ka dashur të thotë se personi mund të agjëronte tre ditë po dhe tre ditë jo gjatë këtyre muajve.

Vlera e muajit Shabani

➤ Çdo të thotë Shaban?

Ibn Haxheri ka thënë: “Njerëzit pas qetësisë dhe pushimit në muajin e nderuar Rexhep, përhapshin në vise të ndryshme me qëllim për të luftuar. Pra, fjala Shaban do të thotë: Shpërndarje dhe përhapje.

➤ Shabani është muaji që agjërohet më shumë pas atij të Ramazanit

Aishja ka thënë se Profeti (alejhi salatu ue selam) agjëronte aq shumë sa që mendonin se nuk asnjëherë nuk qëndron pa agjëruar dhe qëndronte pa agjëruar sa që mendonim se nuk agjëronte kurrë. Nuk e kam parë Profetin (alejhi salatu ue selam) që të plotësojë ndonjë muaj tjetër me agjërim përveç muajit të Ramazanit, ndërsa muaji në të cilin agjëronte më shumë ishte ai i Shabanit.”

Gjithashtu ka thënë: “ Nuk kam parë Profetin (alejhi saltu ue selam) që agjëronte më shumë se sa gjatë muajit Shaban, e agjëronte të gjithë muajin dhe thoshte: “Punoni sa të keni mundësi sepse Zoti nuk lodhet derisa të lodheni ju.”

Ebu Seleme tregon se e ka pyetur Aishen për agjërimin e Profetit dhe ajo iu përgjigj: “Agjëronte aq shumë sa që mendonim se agjëron gjithmonë, dhe qëndronte pa agjëruar sa që mendonim se nuk agjëron asnjëherë. Nuk e kam parë që të agjërojë më shumë se sa muajin e Shabanit, e agjëronte të gjithë muajin Shaban ose nuk agjëronte vetëm pak ditë prej tij”

Umu Seleme tregon: “Nuk e kam parë Profetin që të agjërojë dy muaj të njëpasnjëshëm, përveç muajve të Shabanit dhe të Ramazanit.”

Shabani, muaji më i dashur për agjërim nafile

Ashja ka thënë: “Muaji më i dashur për Profetin për agjërim ishte ai i Shabanit, pastaj e bashkangjiste me agjërimin e Ramazanit”

Hadithet e lartpërmendura nuk bien ndesh me ato hadithe që ndalojnë agjërimin pas mbarimit të gjysmës së muajit të Shabanit.

Ebu Hurejre tregon se Profeti ka thënë: “Kur të ngelet gjysma e Shabanit, atëherë mos agjëroni.”

Tirmidhiu ka thënë: “Kuptimi i këtij hadithi, tek disa dijetarë, është kur njeriu nuk ka agjëruar deri në këtë kohë (gjysmën e muajit Shaban) dhe kur ngelen disa ditë prej tij, fillon të agjërojë për shkak të

afrimit të muajit të Ramazanit. Ebu Hurjere ka transmetuar nga Profeti (alejhi slaltu ue salam) një hadith të ngjashëm me këtë hadith: "Mos i paraprini muajit të Ramazanit me agjërim, përveç atij që agjëronte më parë dhe ky agjërim bie në këto ditë." (Buhariu) Siç është agjërimi i ditëve të bardha apo ai i ditës së Hënë dhe të Enjte.

Ky hadith tregon se është e papëlqyer që të agjërohet qëllimisht për shkak të afrimit të muajit të Ramazanit.

Bazuar hadithet e lartpërmendura, themi se tradita profetike është që të agjërohet i gjithë muaji Shabanit ose pjesa më e madhe e tij. Ndërsa ai që nuk agjëron nga fillimi i tij, më pas dëshiron të agjërojë pas kalimit të gjysmës së tij, futet tek hadithi që ndalon agjërimin. Po kështu ky ndalim përfshin edhe atë person që dëshiron të agjërojë në fund të muajit Shaban me qëllim të pritjes së muajit të Ramazanit.

➤ **A mund të agjërohen më vonë (kaza) ditët e muajit Shaban?**

Profeti ka urdhëruar që të agjërohet më pas, nëse nuk është agjëruar në muajin e Shabanit. Imran Ibn Husajn ka thënë se Profeti (alejhi saltu ue salam) e ka pyetur: "A ke agjëruar nga fundi i muajit Shaban?"

Jo, i tha.

Kur të mbarosh, agjërimin (e Ramazanit), agjëro dy ditë." (Buhariu dhe Muslimi)

➤ **Urtësia e agjërimin të mujtim Shaban**

Usame Ibn Zejdi (radijZoti anhu) ka thënë: E pyeta Profetin (alejhi saltu ue salam): O i Dërguari i Zotit, nuk të kam parë të agjërosh ndonjë muaj më shumë se ai i Shabanit? Profeti

i tha: "Në këtë muaj njerëzit janë të pavëmendshëm, muaji i cili ndodhet mes muajit Rexheb dhe muajit të Ramazanit. Ky është muaji në të cilin punët ngrihen tet Zoti i botëve, dhe unë dëshiroj të jem agjërueshëm kur të ngrihet puna ime." (Vlera e natës së mesit të muajit të Shabanit

Ebu Musa El-Esharij (radijZoti anhu) tregon se Profeti (alejhi saltu ue salam) ka thënë: "Vërtet Zoti hedh shikimin në natën e mesit të muajit Shaban dhe i fal të gjitha krijesat e tij, përveç politeisin (mushrikun) dhe atë që ka armiqtë dhe është grindur me dikë tjetër." (Ibn Maxhe, Albani thotë: hadith hasen, Sahihul Xhami' 1819)

Në një transmetim tjetër thuhet: "Zoti hedh shikimin natën e mesit të muajit Shaban tek krijesat e tij dhe fal robërit e Tij përveç dy personave: "Atë që ka armiqtë dhe vrasësin."

Kurse në një hadith tjetër Profeti (alejhi saltu ue salam) thotë: "Kur të jetë nata e gjysmës së muajit Shaban, Zoti hedh shikimin tek krijesat e tij dhe i fal besimtarët, ndërsa mohuesve iu jep afat dhe njerëzit që kanë mëri me njëri-tjetrin i lë ashtu në mërinë e tyre derisa të largohen prej saj."

Në hadithet e sipërpërmendura, tregohet vlera e natës në gjysmën e muajit Shaban, Zoti na e mundësoftë që të jemi nga ata që iu falen gjynahet. Megjithatë kjo nuk do të thotë që në këtë natë të caktojme një adhurim të posaçëm, sepse veçimi me adhurim të veçantë nuk ka bazë dhe as argument të saktë në fenë islame. Prandaj çdo veprim në këtë natë me qëllim veçimin e saj me adhurim zë veçantë është veprim i shpikur në fe, siç bëhet me faljen e namazit, etj.


A E PRISHIN AGJËRIMIN INJEKSIONET DHE ILAÇET?

Nga: D.Ahmed Muhamed Halil, profesor në Univeristetin e Kasimit, Arabi Saudite.

Falendrimi i takon Zotit, mirësia dhe paqja e Tij qofshin për profetin Muhamed dhe pasuesit e tij.

Ajo që e prish agjërimin, sipas argumenteve, konsiderohet kur ushqimi futet në brendësi të trupit në stomak dhe jo nga një pjesë tjetër e tij. Më rrjeshtat e mëposhtëm le të shikojmë ilaçet dhe injeksionet më të përdoruar dhe gjykimin e tyre në islam në lidhje me agjërimin.

- Avulli i astmës, **nuk e prish** agjërimin në mendimin më të saktë.
- Kokrrat që vihen poshtë gjuhës për të mjekuar krizat e zemrës, thithen në mënyrë direkte dhe **nuk e prishin** agjërimin.
- Thënia më e saktë është se vetëm lënda ushqyese që futet në brendësi të trupit **e prish** agjërimin, kurse ajo që nuk është ushqyese **nuk e prish**.
- Mendimi më i drejtë është se vëzhgimi që bëhet me aparate në stomak (sondë) **nuk e prish** agjërimin.
- Pikat që lëshohen në hundë, **nuk e prishin** agjërimin.
- Oksigjeni që merret me aparate **nuk e prish** agjërimin.
- Avulli që merret me gojë **nuk e prish** agjërimin.
- Nëse narkoza përdoret për të gjithë trupin, ku i sëmuri e humb vetëdijen, agjërimi **prishet**, por nëse narkoza është vetëm për një pjesë të trupit, pra mpirje e pjeshme, **nuk e prish** atë.
- Pikat që lëshohen në vesh **nuk e prishin** agjërimin, sepse nuk arrijnë në brendësi të trupit.
- Gjithashtu pikat që lëshohen në sy **nuk e prishin** agjërimin, sipas mendimit më të saktë të shumicës së dijetarëve.
- Injeksioni që bëhet nën lëkurë, në muskul ose në damar **nuk e prish** agjërimin, kur nuk është ushqyese, sipas mendimit më të saktë të pjesës dërrmuese të dijetarëve.
- Injeksioni që bëhet në damar dhe është ushqyese (siç është serumi) **e prish** agjërimin.
- Vajrat, kremrat dhe ngjitëset që përdoren për mjekim, **nuk e prishin** agjërimin.
- Vëzhguesi (laparaskopi) i barkut **nuk e prish** agjërimin.
- Pastruesi veshkave, zakonisht shoqërohet me lëndë ushqyese dhe sheqerna, prandaj **e prish** agjërimin.
- Pastrimi i vaginës, vëzhgimi me aparte, e të tjera si këto **nuk e prishin** agjërimin, sepse nuk arrin në stomak dhe nuk ndonjë shkak që ta prishë atë.
- Injeksioni në rrugë anale nëse përmabn lëndë ushqyese apo ujë të cilat i thith stomaku, **e prish** agjërimin, sepse fuqizon trupin.
- Supostet që jepen në rrugë anale **nuk e prishin** agjërimin.
- Vëzhgimi i rrugëve anale me aparate **nuk e prish** agjërimin.
- Vëzhgimi i fshikëzës, futja e ndonjë ilaçi brenda saj ose një lëndë që ndihmon në qartësimin e rezeve, **nuk e prish** agjërimin.
- Dhurimi i gjakut, në mendimin më të saktë të dijetarëve **nuk e prish** agjërimin.
- Dhënia e gjakut për ananliza **nuk e prish** agjërimin.



NGA

AHMED KALAJA

LIGJËRUES PRANË

XHAMISË "DINE HOXHA"

A mund të agjëroj nëse nuk falem?

A. kalaja:-Mund të agjëroni sigurisht por njëkohësisht duhet të dini se namazin nuk ka gjë që e zëvendëson dhe se namazi është shumë më i lehtë se agjërimi dhe se namazi është në renditje para agjërimit megjithatë ju mund të agjëroni. Allahu na mundësoftë që me këtë agjërim të arrijmë devocionin !

A ka moshë për të moshuarit që nuk agjerojnë apo merret masë për ata të sëmurët e të tejkaluarit në moshë?

Nuk përcakton feja ndonjë moshë fikse për të moshuarit po çdo gjë varet nga mundësia nëse i moshuari ka mundësinë të agjërojë dhe kjo gjë nuk përben rrezik për jetën ose shëndetin e tij ose nuk është shkak që atij t'i përshakllëzohet një sëmundje apo t'i shtohen problemet shendetësore atëherë duhet të agjërojë nëse ndodh një nga gjërat e lartpërmendura duhet që të kompensojë ose të shpagojë sipas rastit (ëallahu aelem)-Allahu e di më së miri!!

Si mund të mbushet një ditë në fillim agjërimi?

Për këtë nuk mund të jepet një recetë fikse varet nga puna, angazhimet që ka personi po me sa më shumë vepra të mira aq më mirë është si psh kujdesi ndaj namazit farz dhe syneteve , lidhjeve farefisnore , leximi i Kuranit , pendimi te Allahu përmendja e Allahut , sadekaja etj

Muaji i Ramazanit është muaji kur u zbrit Kurani, a ka ndonjë sure me emër të veçante e karakteristika të veçanta që mund të lexohet apo lexohet i gjithe libri?

Ponë këtë muaj Allah u zbriti Kurani dhe shumë libra qiellore njëkohësisht dhe kjo është veçoria me veçantë dhe karakteristike , efikase e këtij muaji dhe jo vetëm Kurani po librat më të rëndësishëm qiellorë kanë zbritur në këtë muaj si Teurati, Taora, Zeburi, Psalmet, Inxhili Ungjilli, Suhuf Ibrahim dhe Kurani siç dihet. E mirë është që në këtë muaj besimtarët të lexojnë librin të tërë nga fillimi në fund.

Sa ndikon Ramazani në qëndrueshmërinë e besimtarit në fe?

Agjërimi është një tregues i mirë i besimit dhe si çdo adhurim ai lë ndikimin e tij në rritjen e imunitetit të besimtarit ndaj sprovave dhe

sfidave më të cilat ai përballlet vazhdimisht sepse ai në vetvete është një mburojë e mirë për çdo besimtar dhe besimtare ndaj dënimit të Zotit .

Si shpërblehet një punë e mirë, e veçantë në Ramazan?

Ndonjë transmetim specifik disi të veçantë nuk ka por, për një gjë duhet të jemi të sigurtë se vepra e mirë në ramazan është shumë më e vlerësuar të Allahu së e njëjta vepër dhe jashtë këtij muaji,sepse ky muaj është quajtur i begatë dhe i bekuar.

A e prishin agjërimin injeksionet e detyrueshme ?

Nëse janë ushqyese si serumi, priset agjërimi po njeriu nuk është mëkatar dhe këtë ditë ose grup ditësh e agjëron dhe kompenson më vonë.

Nëse nuk janë ushqyese si antibiotikët , vaksinat etj atëherë nuk priset agjërimi .

Hixhamja ose nxjerrja e gjakut me anë të kupëzave që është dhe traditë Profetike në kurimin e sëmundjeve a e prish agjërimin ?

Opinioni me i drejte në lidhje me këtë çështje është se nuk priset agjërimi megjithëse kjo është një çështje e diskutueshme mes shkollave të njohura juridike islame.

Po dhurimi i gjakut a e prish agjërimin?

-jo normalisht që nuk e prish.

pompa e aztmës ?- normalisht që jo

Duhani?-

Nuk ka dyshim që po. Jo vetëm kaq por duhet të dijmë se gjykimi i fesë mbi të është se është i ndaluar .

Çfarë mund të thoni për teravitë?- a janë traditë apo mëshirë e ndjekjes së asaj çfarë na la trashëgimi profeti i fundit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të.


Teravitë ose namazi i teravive padyshim që është një traditë e veçantë e Profeti alejhi selam që muslimanët e kanë trashëguar brez pas brezi nga i dashuri i Zotit dhe i Derguari i Tij dhe një traditë që populli ynë i ka kushtuar kujdes madje edhe në kohën e monizmit ka pasur njerëz që kanë falur teravitë individë dhe grupe .Një traditë që muslimanët nuk duhet ta lënë pas dore .Le të falen sa falin imamët e tyre,dhe mos të bëhet shumë zhurmë për numrin e rekateve por të falen muslimanët siç falen imamët e tyre .

NGA

AHMED KALAJA

LIGJËRUES PRANË

XHAMISË "DINE HOXHA"



Për kë ka më shumë rëndësi, teravia, është njësoj si për burrat edhe për gratë?

Është synet në të drejtë të të dy palëve por, normalisht për burrat dhe më i rëndësishëm sepse gratë mund të falen edhe në shtëpitë e tyre .

Si e shikoni ndarjen e Ramazanit në tre fraksione aq të rëndësishme për agjëruesit: mëshirë, falje shpetim nga zjarri i xhehenemit (3 dhjetëditë-shat)?

Nuk ka ndonjë argument specifik për këtë e themi këtë si traditë profetike të saktë po kjo është bërë e njohur te njerëzit; e rëndësishme është të dijë që me të vërtetë ky muaj është i mbushur me mëshirën e të Gjithëmëshirshmit dhe me faljen e Tij dhe se padyshim në këtë muaj shumë njerëz do të çlirohen dhe cregjistrohen nga listat e e banorëve të zjarrit .

A lejohet një agjërimit pa syfyr?

Lejohet, po, nuk është i pëlqyeshëm sepse njeriu do të dembeloset nga detyrime të tjetra që mund të ketë ndaj Zotit ose familjes ose punës apo shoqërisë gjë që i ul vlerat te Zoti agjerimit .

Edhe nese ke anoreksi pi qoftë edhe një gllëjkë ujë se në të ka mbarësi siç ka lajmëruar Profeti i Islamit madje është koha më e mirë për t’ju lutur Allahut të madhëruar siç Ai vetë na ka treguar nëpërmjet profetit Muahmed salallahu alejhi  e selem .

A lejohet të jepet fitri nga një familje që nuk ka agjëruar?

Sadekatul fitri jepet nga familjet muslimane të cilat kanë agjëruar ose i ka penguar nga agjërimi ndonjë arsye e konsideruar fetare .

6. Cila është mosha e fëmijëve agjërues?

Puberteti obligon 10 vjeç e lart mësohen,7 vjeç e lart edukohen me edukatë agjërimiti .

Si gjykohet hapja para kohe e iftarit?

Nëse e bën pa vetëdije nuk përbën problem

Nëse e bën se je i bindur se ka hyrë koha pastaj kupton se nuk kishte hyrë koha, sërish nuk ka gjë

nëse e fillon para kohe me vetëdije, prishet agjërimiti i asaj dite

Cilat janë gabimet e një agjëruesi?

Shirku, idhujtaria dmth kushtimi i adhurimit dikujt tjetër veç Allahut,ose të shpresojë se dikush mund të bëjë atë që mund të bëjë Allahu si ata që shkojnë nëpër varre apo “vende të mira” që kërkojnë prej të ashtuquajturve evlija t’i ndërmjetësojnë me Allahun.

-mos falja 5 herë në ditë

-mos heqja dore nga haramet gjatë ditës

-përgojimi

-sjellja e keqe

NGA

AHMED KALAJA

LIGJËRUES PRANË
XHAMISË "DINE HOXHA"

Sa ndikon një iftar që hapet me shumë vëllezër e motra besimtare së bashku?

Normalish ky është një tregues i devotshmërisë dhe i vëllazërisë dhe i solidaritetit ndërvëllazëror tregues i mëshirës dhe tregues se Ramazani po jep efektet e veta të kërkuara prej tij .

Si vlerësohet ftesa dhe përgjigja e saj në Ramazan?

Njësoj si në rastet e tjera pra është detyrë t'i përgjigjesh ftesës.

Sa rëndësi i është dhënë ramazanit dhe agjërimit në Kuran në varësi të mbarë tematikës kuranore?

-Një trajtim i plotë i juridiksionit dhe pozitës spirituale më shumë vend se shumë adhurime të tjera që në rastet e tjera janë sqaruar nëpërmjet traditës Profetike .

Cilat janë temat për të cilat flet në të shumtën e sureve krijuesi i Gjithësisë?

Janë tre tematika:

Njeshmeira e Allahut, Teuhidi ose monoteizmi

Ligjet- jurispidenca

Ngjarjet dhe historite e Profetëve dhe popujve apo individëve të veçant.

Si qëndron hapësira e trajtesave lidhur me krijimin, caktimin, dijen njësimin e Zotit?

Pothuajse në propocion të barabartë.

A janë urdhëruar edhe profetë të tjerë për agjerim?

Po, padyshim edhe sot e kësaj dite prej pasuesve të feve të tjera ka që agjërojnë.Kjo do të thotë se Profetët, të tërët janë urdhëruar për të agjëruar.

Sa lloj agjërimesh ka, kjo duke pare agjërimin e të parëve tanë?

Agjërimi i masave thjesht nuk hane dhe nuk pine dhe përmbahen kontaktit seksual nga agimi në perëndim të diellit agjerimi i besimtarëve të vërtetë që përmbahen nga çdo e ndaluar dhe janë korrektë ndaj asaj që Zoti ka urdhëruar

Si duhet të karakterizohet namazi në këtë muaj?

si gjëja më veçantë dhe simbolika e tij argument për këtë kemi namazin e teravive i cili është shtuar plus vetem në këtë muaj.





Pranvera e jetës sime

Nuk e kuptoj se si përplasia e jetës më risjell te ti. Afrohesh, largohesh dhe përsëri me kokën pas dhe me sy nga ti mbetem.

Ti je shpresa ime, jeta ime e vërtetë, ti je për mua...

A nuk është paradoksale se si dimri, ose më mirë një dimër i jetës time u bë pranvera e përjetësisë.

Jeta ka hovet dhe tallazet e saj. Unë në këto valë e tallaze u përplasa me jetën e vërtetë. E përthitha atë tërësisht, thellësisht, përjetësisht.

Nuk po më kuptoni?! E di !Dhe që të qartësohemi deri në detaj po ju them se atë dimër unë njoha dhe përqafova fene islame.

Në vitin 1992 unë kisha dorëzuar në duart e Krijuesit tim, nënën time të shtrenjtë. Kjo ngjarje më kishte krijuar një vakum në shpirt. Më mungonte oksigjeni për të vazhduar jetën me forcë. Nuk mund t'ia dilja mbanë në këtë botë të madhe . Ajo ishte për mua gjithçka dhe tani unë mbeta pa asgjë. Telat e jetës tashmë për mua ishin këputur dhe unë kisha mbetur e varur në një fije peri. Vetëm kjo fije me mbante gjallë.

Flatrat mëmësore që më mbulonin dhe më mbronin nga rrebeshet e jetës, tani nuk ishin më. Kishte filluar çdo ditë e më shumë të më zvogëlohej dëshira për të ecur përpara.

Jeta për mua nuk ishte më me ngjyra. Ajo ishte kthyer si një negativ filmi, vetëm bardh e zi.

Nuk e kisha menduar se do të kisha më forcë për të qenë përsëri vetvetja dhe se do ta doja jetën përsëri kaq fort.

Pikërisht në vitin 1995, kur isha vetëm 13 vjeçe, unë fillova të njihem me një kulturë tërësisht tjetër, atë islame. Krijova rrethe shoqërore të cilat me ngrohtësinë dhe konfortin që më ofruan, me jepnin ndjesinë e të njohurit prej vitesh.

Ditët të cilat kishte kohë që më dukeshin si shekuj, tani nuk l ndjeja fare.

Ishte hera e parë që dëgjoja fjalën Ramazan. Më dukej pak e çuditshme se si njeriu e privon veten nga kënaqësia njerëzore për të arritur kënaqësinë hynore.

Ky kuriozitet i vetësublimimit më shtyu të njoh detin e paanë e të pafund të islamit. Njerëz që sapo njihen dhe të duket sikur i njeh prej vitesh, ndihmesa të cilat nuk t'i ben as ndonje mik i aferm apo familjar. Dukej qe frymzimi i tyre ishte hyjnor.

Pas pak kohësh ndoshta dy jave, deshmova shehadetin, ndalova te gjitha ushqimet dhe pijet e ndaluara, fillova të fal namazin dhe të shijoj ëmbëlsinë e tij.

Tashmë isha gati, po, isha gati vërtet për një Ramazan të plotë , sipas normave të islamit.

Natën e parë të ramazanit për një ëndërr sikur isha në qiell dhe yjet të ndritshme më vinin pranë. Ishte një kënaqësi të cilën edhe sot pas 17 vitesh e kujtoj. Nuk e shpjegoj dot sepse vërtet gjërat që i përjeton shpirti nuk mund të shpjegohen me fjalë.

Në fillim nuk e kuptoja, por tani e di se çdo të thotë kënaqësi e besimit. E ndjej dhe e përjetoj atë. Pas pak vitesh unë vura edhe një petk mes bukurisë time dhe botës, por jo mes intelektit tim dhe asaj, pra u mbulovala. Më pas mbarova studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe.

Kur vendosa të agjëroj, nuk e di si ta shpjegoj. Më dukej vetja sikur fluturoja, si njeri me krahë. I tregoja për agjërimin tim çdo njeriu që takoja.

Eh! Si mund t'jua tregoj, është një forcë e brendshme e cila rrjedh nga shpirti. Nuk është largim vetëm nga ushqimi, por edhe nga të gjitha veset e botës.

A nuk janë vallë veset që po e prishin dhe po e degradojnë këtë botë?... Pra mungesa e tyre përmirëson botën dhe njerëzimin.

Gjatë muajit të ramazanit ndalohen:

mendimet, sjelljet e pahijshme, përgojimet, imoraliteti, vjedhja etj...

Duke u skalitur me të gjitha këto, ne mund të përsosim vetveten gjithmonë e më shumë.

Nëse çdo adhurim e bëjmë për vete, agjërimin e bëjmë për Zotin.

Ti o muaji shkurt ishe për mua:

Islami im

Shehadeti im i parë

Ramazani im i parë

Namazi im i parë

Ti ishe, je dhe do të jesh
pranvera e jetës dhe e zemrës sime.

Ëmbëlsirë e këndshme me shije të rafinuar
(-3 lloje qumështi)

Përbërësit: 10 kokra vezë

- 10 lugë gjelle sheqer
- 10 lugë gjelle miell
- 500 ml qumësht panna (psh. Hople)
- 1 l qumësht kutie
- 350 ml qumësht i kondensuar (psh. panda)
- 300 ml karamel i parapërgatitur
- pak vaj për tavën për pjekje

Trileçe

Udhëzime për përgatitje

Ndajmë të bardhat nga të verdhat e vezëve në enë të veçanta. Shtojmë sheqerin në enën me të bardhat e vezëve dhe i rrahim me mikser derisa të bëhen marengë. Shtojmë të verdhat, të rrahura me parë në enën ku i kemi vendosur, duke i përzier ngadalë me të bardhat e vezëve me tel kuzhine. Pasi të lidhen shtojmë miellin gradualisht, lugë pas luge, duke e përzier me kujdes me qëllim që të mos e humbasim volumin. Tavën për pjekje e lyejmë me pak vaj dhe e shtrojmë me letër kuzhine për pjekje në mënyrë të tillë që vaji të mos ketë kontakt me ëmbëlsirën. E hedhim në tavë masën e përgatitur dhe e pjekim për 5 min në furrë të paranxehur në 250 gradë dhe pasi të jetë pjekur sipër e ulim gradën e furrë në 150 gradë dhe e lëmë të piqet edhe për 10 minuta të tjera. Nërkohë përgatisim përzierjen me 3 llojet e qumështit: hedhim qumështin panda në një enë për përzierje dhe shtojmë qumështin e kutisë. I përziejmë derisa të tretet qumështi "panda". Më pas shtojmë qumështin pana dhe masa është gati. E heqim pandispanjën nga furra, e kthejmë në një tavë tjetër në mënyrë që ti heqim letrën dhe e lëmë të ftohet. Pasi ftohet e presim në sa copë të dëshirojmë dhe i hedhim përzierjen e qumështit derisa ta absorbojë të gjithën. E lyejmë sipër me karamelin e parapërgatitur.

Përbërësit:

gjysëm kg mish i bardhë pule (mish gjoksi)
gjysëm litër krem Hopla
djathë i bluar :4 djathrat:-kackavall,djalth i
bluar parmezan,vegëgë dhe erëza
Udhëzime për përgatitje

Mish pule me salcë të bardhë

Mishin e bardhë e presim ne rrisa të gjata dhe të holla në formë gishti.E fërgojmë rreth 10 minuta.Përderisa tigan me këtë masë është ende mbi pllakë të nxehtë,mbi të hedhim kremin Hopla dhe të gjitha llojet e djathërave,vezën si dhe erëzat.Të gjitha këto i lëmë të vlojnë në temperaturë të ngadalshme për afërsisht 20 minuta.Shërbehet me patate të skuqura,spageta apo çfarëdolloj paste.

Tortelini

Përbërësit

tortelini 500 gr
mish i grirë 200 gr
domate 1 kokërr
kripë , piper
pana 1 kuti
2 lugë pesto genovese lloj salcë me borzilok


Udhëzime për përgatitje

Skuqim mishin në pak vaj ulliri.

Hedhim domaten e grirë në kubik.

hedhim kripë e piper dhe i gatujmë për 15 min.

hedhim panën.peston dhe i lëmë ne zjarr sa të lidhen.shtojmë tortelini të ziera më parë dhe i lëmë në zjarr për disa minuta sa të marin shije.



Gatujmë në Ramazan

oriz per rizoto 4 filxhan
gjalpe sipas deshires
perime te ngrira (mikse me bizele, miser,
karrota,) sipas deshires 500 gr te gjitha
safron (zafferrano)
kripe sipas dëshirës

Rizoto

Përgatitja

Në një tigan të madh hedhim pak yndyrë e gjalp, ose vetëm gjalp.

Shtojmë perimet dhe i lëmë të

fërgohen pak në tigan ndërkohë që përgatisim orizin. Më pas shtojmë dhe orizin për tu fërguar të gjitha bashkë në tigan. Shtojmë kripën, Zaferanon, dhe 6 Filxhan Ujë. E mbulojmë tiganin dhe e lëmë rizoton derisa të ketë pirë të gjithë ujin.



Agjërime të lehtë!

Art grafika:
Ornela Bita

BASHKËPUNËTORË:

ELSA XHAI- gazetare - Kryetare e Shoq. "Gruaja në media"
SHEGA MURATI - Kryetare e Shoq. "Zëri i fëmijëve na thërret"
JULIANA AJDINI, Prof. Fakulteti Shkencave Sociale.
A. KALAJA - teolog, G. LECINI - gazetar

© Të gjitha materialet e botuara në revistë janë të rezervuara për botuesin e "Përtej fjalës".
Nuk lejohet përdorimi, riprodhimi apo publikimi i tyre pa lejen e botuesit.

Shtypi: "Ilor"

KËSHILLI I REDAKSISË:

ADELINA KASEMI;
ERIONA KODRAGJINI;
ENTELE HIDRI;
ARMIDA PLUMBI;
ENKELEDA RROSHI;
EDLIRA DURMISHI.

Pikpamjet e paraqitura në revistë nuk shprehin domosdoshmërisht pikpamjet e revistës.

Mirëpresim sugjerimet tuaja, idetë e opinionet

pranë adresës sonë:

e-mail: pertejfalës@gmail.com



Mirësevini në *Oriental style*

Dyqani i cili është identifikuar përnjëherësh si ai në anën e xhamisë "Dine Hoxha", me rroba e veshje femërore, vjen këtë sezon veror duke e paraprirë Ramazanin me "Thesaret e Orietit" sa ekzotik e mistik. Gama e gjerë e ofertave të këtij sezoni bashkuar kjo me çmimet konkurruese, ju sjell më afër zgjedhjeve të zgjuara për një veshje e gjitha e stiluar ashtu siç dinë të stilohen shijet e klasit femëror.

Mundësi pa fund zgjedhjesh, ngjyrash, dizenjosh, përmasash, emrash të mëdhenj të artit klasik e modern, oriental e perëndimor, të gërshetuara më së miri me asistencë katalogësh, ju presin!

Mjafton të zgjoheni dhe ta filloni ditën me një zgjim të zgjuar që ju vesh me stilime përrallore.

Adresa:

Rr. Kont Urani, pas xhamisë
Dine Hoxha

Tel.: 067 27 65 110